



## REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 365

Datë: 28.07.2023

### PROCESVERBAL

I mbledhjes së -V- (pestë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës.

### REND I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të rregullt, e mbajtur me datë: 30.03.2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës (Janar-dhjetor) 2022.
3. Shqyrtimi i Planit vjetor të Prokurimit publik.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores përmenaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Malishevës.
5. Shqyrtimi i Planit të punës së Drejtorisë përmjet Bujqësi, përmjet mbjelljet pranverore.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përmjet vlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitet natyrore elementare në bujqësi në Komunën e Malishevës.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal përmjet integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Malishevës.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit përmjet shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veçanta përmjet vitit 2023.
9. Shfuqizimi i vendimit nr. 02/61 datë: 07.02.2023, përmjet listës së veqantë të pronave të paluajtshme të Komunës.
10. Vendim përmjet pagesën e anëtarëve të Komisioneve dhe Komiteve jo obligative të themeluara nga Kuvendi i Komunës.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 08/503 datë: 30.11.2022, e parashtruar nga Zijadin Paqarizi.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/210 datë: 20.04.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/390 datë: 05.09.2022, e parashtruar nga Sabit Mazreku.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/565 datë: 22.11.2022, e parashtruar nga Murtez Thaçi, Sahit Thaçi dhe Flurim Thaçi.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/385 datë: 14.03.2023, e parashtruar nga Adem Hoti.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/637 datë: 22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi.
17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/199 datë: 06.04.2023, e parashtruar nga Luljeta Telaku.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/111 datë: 27.02.2023, e parashtruar nga Sala Krasniqi.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/138 datë: 14.03.2023, e parashtruar nga Naile Kastrati.

20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/141 datë:16.03.2023, e parashtruar nga Shahë Thaçi.
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/151 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Lema Paqarizi.
22. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/247 datë:18.05.2023, e parashtruar nga Gentrit Krasniqi.
23. Të ndryshme.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të Kuvendit të Malishevës. Të pranishëm jemi 27 anëtarë të kuvendorit dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja. Kourum kemi dhe mund të vazhdojmë punimet e seancës, para se të fillojmë me rendin e ditës i kemi në dispozicion 30 min për debat jashtë rendit të ditës.  
Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë!

Sa i pëket jashtë rendit të ditës unë kam disa pyetje dhe sqarime për Kryetarin dhe qeverisjen Kastrati. Qështja e parë ka të bëjë me konkursin për Drejtor shkolle në shkollën filllore të mesme të ulët “Ganimete Tërbeshi” në fshatin Astrazup, ku njëri prej kandidatëve për Drejtor në shkollën në fjalë ka publikuar një aktakuz të ngritur lidhur me rastin e zgjedhjes së drejtorit, ku thekson që ekzistojnë dëshmi të plota se konkursi është manipuluar nga anëtarët e Komisionit nga Komuna e Malishevës. Nëse kjo qëndron turpi i mbulofit ata anëtar të Komisionit të cilët kohë më parë Drejtoresha i cilësonte si tejet profesionist të fushës arsimore. Kryetar Kastrati qfarë do të ndërmerrni në këtë rast me individ të tillë që po ta zbehin punën dhe angazhimin tënd, a do ta anuloni vendimin dhe të nxjerni një vendim të ri për drejtor në fshatin Astrazup. Çka do të ndërmerrni për zyrtarët të cilët kanë kryer vepër penale?

Qështja tjetër ka të bëjë me qentë endacak dhe rasti i datës 29.04.2023 ku si pasoj e qenëve endacak afér bankës NLB, rrëth orës 18:00 është sulmuar një vajzë e moshës afërsisht 10 vjeçare. Qentë endacak janë bërë një shqetësim për qytetarët e Komunës tonë, a keni parapa ndonjë mundësi për zgjidhjen e këti problemi?

Qështja tjetër ka të bëjë me një kërkes nga ana ime, që rrugët përballë sheshit të dëshmorëve dhe në rrugët ku ekzistojnë mundësit në qendër të Malishevës të pastrohen më shpesh dhe më mirë.

Qështja e fundit sa i përket jashtë rendit të ditës ka të bëjë me një kërkes që me datën 29.05.2020 te mandati i kaluar ku kanë kërkuar që urgjentisht të largohen të gjitha mbeturinat dhe mjetet kancerogjene si pasoj e përdorjes së gomave dhe mjeteve të tjera kancerogjene konkretisht në fshatin Bardh dhe Ngucat. Në kto fshatra ku janë përdorur gomat dhe mjetet e tejra në atë kohë kemi marrur zotim të drejtpërdrejt nga Inspektoriat që brenda disa ditësh do të pastrohen ato zona dhe pjesë të natyrës dhe kjo fatkeqësisht nuk ka ndodhur dhr pse tash jemi në vitin 2023. Andaj kërkojmë nga drejtorit përgjegjëse që premtimin dhe zotimin e ish drejtorit ta rikuperojnë sa më mirë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Kam një kërkesë për Drejtoreshën e Arsimit- kërkes nga dy prindër të dy nxënësve të shkollës në Gjimnazin “Avdyl Frashërin” janë të cilët kanë ngecje në zhvillimin mendor dhe ju duhet një përkujdesje shesë ose orë shesë për këtë kategori. Edhe me ligji ju garantonët një trajtim i tillë i veqant dhe me një udhëzim administrativ, ndërsa një gjë të tillë Drejtoria nuk e ka bërë kështu që këkoj

seriozisht të mirret me këtë rast Drejtoresha e Arsimit dhe ta trajtoj këtë kategori të veqant. Qështja tjetër është një kërkes për Drejtorin e financave, ne para tre muajve i kemi miratu disa kërkesa për të cilët kanë nevoja financiare për shërim, është fjala për Ajshe Krasniqi e cila vuan dhe ka përfunduar dy operacione në Tiranë. Kemi nda një shumë të mjetet ende nuk janë ekzekutuar, kërkoi nga ju Drejtor që t'i gjeni sa më shpejt mjetet dhe të përfundohet pagesa.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Përvendetje për të gjithë!

Qështja e parë është një kanalizim në fshatin Berishë dua të di a ka fillu si proces me u rregullu, sepse më ka ardhë një kërkes nga një qytetarë Shkelqim Berisha ai nuk jeton këtu, jeton në Amerik dhe uji komplet i fshatit derdhet në pronat e tij dhe është kontaminu e gjithë sipërsaqja. Janë dhe dy burime të fshatit ku janë bërë të pa piyshme për arsyet atyre ujrate të zeza.

Qështja dytë ka të bëjë me objektin e shoqatave të dalura nga lufta, tash një vit drejtor më kujtohet që ta kam bërë si pyetje dhe premtimi ka qenë që në qershori të vitit të kaluar do të lëshohet në shfrytëzim projekt. Ku janë procedurat, përsë ka ngec projektin dhe pse tash e një vit nuk realizohen këto mjetet?

Qështja tretë ka të bëjë me një kërkes për një rrëth-rrotullim që duhet me u ndërtu te hyrja e fshatit Tërpezë. Janë 5-6 fshatra që kyqen në rrugën "Adem Jashari", është rrugë që e lidh Malishevën dhe Rahovecin me Prishtinen, është e pamundur me u kyq në rrugën kryesore direkt për arsyet të komunikacionit ku duhet të presim ndoshta 10 min për tu kyqur, sepse janë Lladroci, Tërpeza, Berisha, Kleqka dhe këto fshatrat tjera të cilët kanë qasje në këtë rrugë. Është e domosdoshme me u bërë një rrëth-rrotullim sepse është e rrezikshme, vetëm dy apo tri vitet e fundit së paku 3 aksidente janë me fatalitet.

Qështja tjetër është dezinsektimi i rrëqgrave, në muajin e kaluar e kam bërë si pyetje. Jemi vonë të paktën nuk kam parë që Komuna ka fillu ndonjë proces, Nënkyetari në mbledhen e kaluar ka thënë që është në procedur në prokurorim dhe do të fillojmë me kohë mirëpo përfundoj dhe muaji Maj dhe ende nuk ka ndonjë zhvillim. Përsë nuk ka fillu ende kjo procedur dhe ku është aktualisht si procedur?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Përvendetje për të gjithë!

Unë kam një qështje të cilën e kam diskutuar dhe më herët këtu është fjala për fshatrat Carrallukë, Drenoc dhe Vërmic rruga kryesore është duke shkuar rrëth përfundimit aq shumë që është e dëmtuar, është duke u dëmtuar edhe prej qytetarëve ku po prehet rruga, përveq që e prejn rrugën vendosin dhe gurë në atë pjesë që na mos të kalojmë në pjesën e tyre dhe përmbyt gur vendosin bari. Ju kisha lut që inspektoriat të dalin në atë pjesë dhe ta kontrollojnë atë rrugë se qka po ndodhë, sepse është shumë e dëmtuar.

Qështja tjetër është e kam ngritur dhe më herët si shqetësim por nuk është marrë parasysh. Rruga që lidh lagjen Dobruna dhe lagjen Zogaj në Llozic aty është bërë deponi e mbeturinave dhe ne e dimë që aty kalojnë fëmijët për në shkollë aty po grumbullohen dhe shumë qenë endacak. Ju kisha lut ta merrni

parasysh dhe të ndërmerrni ndonjë hap.

E kam një pyetje për Drejtoreshën e Arsimit, sa është duke u bërë pregaditja apo sa janë duke u mbajtur orë shtes për nxënës të klasave të nënta që është shumë afër testi i arritshmëris?

A është ndonjë shkollë duke u pregadit, më shumë më duken janë të fokusuar në mbrëmje të semimaturës dhe ekskuzione se sa për test.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Në seancën e fundit e kemi pasur një prezantim të KDI-së dhe DEMOSI-t, për me sqaru qasjen e pozicionit tim brenda grupit të LDK-së, unë nuk jam në pozicionin e shefit të grupit të LDK-së këtë e bëra për qasje të monituruesve të KDI-së dhe DEMOS-it.

Qështja tjetër është kanalizimi në fshatin Kijevë, ne kemi pasur një kontakt me Drejtorin e Urbanizmit dhe është cekur që do të rregullohet kjo qështje, por ende asnje gjë nuk është marrë në drejtim të kësaj qështje.

Qështja tjetër që e ngriti Valoni, konsideroj që është momenti i fundit me rregullu qështjen e menaxhimit të shkollave sidomos qështjen e arsimit. Ne po hymë në vitin e 5 që shkollat e Komunës së Malishevës nuk kanë Drejtor. Po i bëjë thirrje Kryetarit i cili është prezent të ndërhyj në këtë qështje.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Së pari dhe ne e mbështesim kërkesën e kolegut tonë Valonit që të mirret seriozisht zgjedhja e Drejtorit në Astrazup dhe në të njëjtën kohë të i jepet epilog, sepse siç e tha ai e ka një aktakuz.

Drejtor i Urbanizmit, i cekën disa herë qështjen e rrugëve lokale, mirëmbajtjen, prerjen ku do që të shkon ka gropë. E di që është një kontrat aktive mundësisht të bëhet një zgjidhje, pjesa e rrugës së Senikut është jashtëzakonisht shumë keq, është në gjendje të tmerrshme.

Te energjia elektrike ku janë procedurat e trafostacionit, e di që ne si kuvend e kemi dhënë një vendim për ndarjen e parcelës e di që i takojn ministris investimet në atë pjesë mundësisht na informo kur do të fillojnë punimet dhe në cilat baza janë.

Qështja tjetër janë dritat, një kontrat që është për mirëmbajtjen e dritave në fshatin Lladroc rruga "Afrim Buqaj", që nga koha e keqe e cila ishte së fundmi ka qenë një djegie është mirë me dërgu dikënd që të i rregulloj.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani:** Pasi që në rend të ditës ka shumë kërkesa për ndihmë financiare, propozoj që të hyjë në rend të ditës kërkesa e datës: 27.03.2023 nr protokoli: 02/160, është kërkes për ndihmë financiare për një fëmij dy vjeqar nga fshati Lladroc, ka nevojë urgjente për ndihmë financiare.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Amrush, në parim e kemi cekur që kërkesat për ndihma financiare të vijnë së pari në KPF pastaj në Kuvend përveq nëse vjen nga ana e Kryetarit.  
Urdhéro, Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kamë vetëm një pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, është fjalë për rrugën në tranzit, e dimë që të gjithë ne e shfrytëzojmë atë rrugën dhe ka nevojë emergjente për një intervenim. Në seancën e kaluar e kam parë një kërkes ku është rregullu një pjesë e vogël e asaj rruge, por ende është në gjendje shumë të keqe shpresoj që me reagu sa më shpejtë. E kam një pyetje dhe për pjesën e rrugës “Ibrahim Mazreku” si është situata për momentin, nuk po shohim që ka shumë zhvillime, kisha kërkua me na dhënë një sqarim më të detajuar.

**Argjend Thaçi:** Meqenëse përfundoj koha e debatit, kërkoj nga ekzekutivi me i dhënë përgjigjet e tyre. E stoj Kryetarin z.Ekrem Kastrati!

**Ekrem Kastrati:** Përshëndelje për të gjithë ju!

Lidhur me konkursin në fshatin Astrazup në shkollën fillore “Ganimete Tërbeshi” kemi pasur një ankes gjatë këti procesi, është e vëmja ankes në kuadër të këti procesi. Ankesa ka shkuar në prokurori, por nuk do të thotë të i shpallim sajtor njerëzit. Për këtë arsyе duhet të presim prokurorin se qfarë thotë dhe sigurisht që pas përgjigjies, qeveria komunale e juaj së bashku me Drejtorin e arsimit ka me i marrë hapat e nevojshëm.

Qenët endacak sigurisht që është një problem që na shqetëson të gjithëve, por është një problem të cilin do të duhet ta trajtonte qeveria. Qeveria e Kosovës është në prag të hartimit të një ligji për rekrutimin e qenëve endacak, sipas informatave të cilat i kemi shumë shpejt do të filloj të zbatohet ky ligj. Kurse qasja selektive përveq Prishtinës të cilës ja ka ndar një fond Bashkimi Evropian e ka bërë një projekt lidhur me trajtimin e qenëve endacak asnjë Komunë në Republikën e Kosovës nuk ka pas një projekt të tillë, sepse nuk mundet secila prej nesh të i trajtojë.

Pastrimi i rrugëve, të gjithë neve po na pengon pastërtia e rrugëve të tona dhe mirëmbajtja e tyre, mirëpo po bëjmë përpjekje maksimale së bashku me kompanin Ekoregjioni që ta mirëmbajtje, mirëpo kërkoj dhe prej ju qytetarë të Komunës së Malishevës që të kenë mirëkuptim për arsyë se tërë ditën ka lëvizje të kamionave.

Largimi i mjeteve kancerogjene sigurisht që është një problem që një kohë dhe ne e kemi drejtuar dhe inspektoriat dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike që sa më shpejtë që është e mundur t'i trajtoj këto dhe për arsyë të pamundësive tona financiare ende nuk kemi projektu, por sigurisht që në prespektiv do të jetë një gjë e tillë.

Për fëmijët me nevoja të veqanta duhet të trajtohet në mënyrën e veqantë qfare dëshirojnë familjet e tyre dhe i respektojm dhe ligjin dhe dispozitat ligjore. Ne kemi një klas në shkollën “Ibrahim Mazreku”, ku i trajtojmë këta fëmijë, por nganjëherë po kemi probleme me transportin e tyre dhe me familjet e tyre që nganjëherë refuzojn t'i marim fëmijet e tyre. Mirëpo ne do të bëjmë përpjekje maksimale që secilin fëmijë me nevoja të veqanta ta trajtojm ashtu siç dëshiron familja e tyre dhe sigurisht dhe ligji.

Kanalizimi në fshatin Berishë me Drejtorin e Urbanizmit jemi duke e trajtuar këtë qështje mirëpo ta

shohim sa kemi mundësi buxhetore që ta inicjojmë procedurë prokuroruse për trajtimin e kësaj vije të ujrave të zeza.

Objekti i shoqatës së veteranëve sigurisht që gati të gjitha punët kanë përfunduar, e kemi formuar një komision për pranimin teknik të kësaj ndërtese mirëpo ta shohim a do kemi më shumë mundësi që të investojmë më tutje, sipas udhëheqësve të shoqatave të dalura nga lufta kjo shoqat duhet të i ketë dhe disa intervenime.

Rrethrotullimi në fshatin Tërpez sigurisht që rrugët magjistrale të cilat janë, kemi shumë kërkesa që të rregullohen mirëpo këto rrugë kontrollohen dhe menaxhohen nga Ministria e transportit dhe çdo ndërhyrje në këto rrugë duhet të kemi leje të posaqme nga ministrit përkatëse respkutive. Ne e kemi dërguar dosjen e kësaj rruge në Ministri të Transportit por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje se a na lejohet ndërhyrja apo jo.

Dezinsektimi për rriqëra tashmë është ka punon komisioni për zgjedhjen e kompanis përkatëse dhe besoj që shumë shpejt ky komision do ta finalizo.

Ruga për në Vërmicë, të gjitha rrugët dhe unë i kaloj sepse kam aktivitete ditore në fshatra. Kjo është një rrugë e cila shumë është dëmtuar dhe besoj që me kontraten të cilën e kemi të themeluar të këti viti ta shohim për mc intervenu në atë segment rrugor.

Lagjia Dobruna në Llozicë, ne në disa fshatra i kemi larguar të gjitha mbeturinat dhe jemi duke i shkuar me radhë në secilin fshat sipas mundësive tona buxhetore.

Kanalizimi në Kijevë e kam parë dhe vet që është në gjendje të tmerrshme, kemi nënshkruar një mirëkuptim me Kryetarin e Kijevës së bashku kemi aplikuar në Ministri të Pushtetit Lokal, sepse ata tani i kanë disa mbledhje për disa projekte në bashkëpunim komunal, dhe ky është njëri prej projekteve dhe së bashku me Kryetarin e Komunës së Therandës i kemi bërë disa marrëveshje .

Premtimet i kemi nga Ministria e Pushtetit Lokal që këtë projekt do ta kemi në konsiderat.

Energjia elektrike ne e dimë qfarë dimri kemi kaluar vitin që shkoj dhe jemi duke u munduar me dhënë maksimumin tonë. Ne kemi qenë në Elkos, në ZRRE dhe në Ministrin e shërbimit elektronik ku të gjithë këta janë akter kyq që duhet ta favorizojnë dhe ta ndërtojnë këtë objekt. Në Elkos kemi marrë përgjigje se Elkos e ka pasur një raport të auditimit dhe raporti i auditimit e ka emërtuar Elkosin që projektet të cilat i ka iniciu nuk kanë pasur projekte. Elkos ka qenë i obligum që qdo projekt të cilin e incijon të ketë projekt, mirëpo tash Elkos e ka iniciu një procedur për hartimin e një projekti dhe mbasi të zgjedh projektin të implementohet. Është një procedur që po na sjell probleme të gjithë neve jo vetëm juve.

Ruga tranzit, renovimi i kësaj rruge është një shqetësim i jashtëzakonshëm, mirëpo me 16.06.2023 bulevardi përkatësisht rruga “Ibrahim Mazreku” do të arrijë në qarkullim, dhe më së largëti deri më l korrik të rregullohet kjo rrugë e tranzitit dhe të funksionalizohet.

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Arbëresha Krasniqi!**

**Arbëresha Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!**

Unë fillimisht dua të ju kërkoj falje që jam vonuar pak por ishim në hapje të garave sportive në Gjimnazin “Hamdi Berisha”. Unë i mora disa pyetje gjatë kohës që unë nuk kam qenë këtu dhe do

mundohem të ju jap sqarime për të gjitha, duke i respektuar të gjitha përgjigjet të cilat i dha Kryetari Komunës, sepse është ashtu siç e tha por në detaje.

Sa i përket testit të arritshmëris ne si Drejtori e Arsimit ju kemi dërguar email të gjithë drejtorëve të shkollave që t'i marrin hapat me kohë në drejtim të gjithë atyre nxënësve të cilët kanë nevoj për orë plotësuese. Te trajtimi i fëmijëve me nevoja të veqanta unë e them me mburrje që gjatë këti viti Drejtoria e Arsimit ka bërë rekrutimin e 5 asistentëve për trajtimin e fëmijëve me nevoja të veqanta, dhe këta asistent i kemi nda pothuajse secilin në tri shkolla, që nënkupton që 100% të shkollave të Komunës së Malishevës janë të mbuluara me asistent për fëmijët me nevoja të veqanta. Unë e di që është e pa mjaftueshme, mirëpo ekipat e vlersimit që i përket nevojave pedagogjike është në teren dhe është një ekip shumë profesionale. Për rekrutimin e Drejtorëve e ceki dhe Kryetari dhe jemi ndër Komunat me më së shumti drejtor të rekrutuar në formë të rregullt.

Labinoti, e ceki që ka shkolla që janë qe pesë vite që nuk kanë drejtor, nuk ka shkollë në Malishevë qe pesë vite pa drejtor por janë me ushtrues detyre dhe janë duke e përfunduar aktivitetin e tyre karshi të gjitha obligimeve që u janë dhënë atyre me vendim nga Kryetari i Komunës.

**Labinot Gashi:** Zyrtarisht nuk ki dejtor dhe ushtrues detyre nuk mundet me qëndru mbi 6 muaj është viti i pestë që shkollat kanë mbet pa drejtor, është e vetmja Komuna e Malishevës që është në këtë gjendje sa i përket menaxhimit.

**Arbresha Krasniqi:** Është e vërtet që janë me ushtrues detyre dhe arsyeshimërin e kemi dhënë në raport si Drejtori e Arsimit se përsë janë me ushtrues detyre, ata nuk i kanë nga 6 muaj ushtrues detyre por nëse nuk gaboj janë në muajin e tretë. 16 shkolla i kemi rekrutu me drejtor të shkollave, unë e them para jush që nuk ka drejtor të shkollave që është i pa përgjegjshëm në gjitha detyrat që ja kemi dhënë ne si drejtori. Sa i përket shkollës ku je ti, nga pas luftha në Malishevë nuk është investuar asnjëher më shumë se që është duke u investu tani në shkollën Institucioni i arsimt dhe aftësimit profesional “Lasgush Poradeci” në Kijevë.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtoreshë, urdhëro Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Drejtoreshë, unë nuk thash që ushtrues detyre janë të papërgjegjshëm, sepse kjo dallon shumë me atë çka e thash. Kryetari, është jurist i dinë procedurat nëse e gjenë se me ligj administrativ ki të drejt 3 ose 4 herë me vazhdhu ushtrues detyre drejtorin, unë të kërkoj falje publikisht, por nuk ki të drejt më shumë se 6 muaj.

**Arbëresha Krasniqi:** Labinot, pyetjen të cilën e bëre do të jetë hera e dytë që do të kërkosh falje, sepse një herë ke kërkuar falje që ke thënë është e pamundur që “Lasgush Poradeci” të shëndrrohet në një institucion të arsimt dhe aftësimit profesional dhe kjo është bërë, ke thënë që është e pamundur drejtimi i mjekësis në atë shkollë dhe kjo është bërë. Mos të na pengoj qështja e kontratave ose vendimeve për njerëzit, por duhet me na pengu ajo që e tha Mirëlinda me kërkuar përgjegjësi dhe punë shtes nga mësimdhënësit për nxënësit përgaditje të testit të arritshmëris, ndërsa këto punët tjera unë besoj që janë punë administrative dhe përmendimin tim nuk do të duhej të gjenim kohë të merremi me diskutime të tillë.

**Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtor Blerim Thaçi!**

**Blerim Thaçi:** Dëshirova të i përgjigjем Albanit për pyetjen të cilën ma bëri në lidhje me ndihmat financiare, e dini që vendimet e marra prej asambles komunale po zgjasin procedura pak më të gjata, për arsy se së pari duhet të kthehet përgjigjia prej MAPL-së dhe pastaj të kompletohet dokumentacioni, të shkojnë për sistem të futen në sistem dhe të ju ekzekutohet pagesa. Përveq kësaj KPF është i njostuar për arsy të mundësive të vogla buxhetoreështë e pamundur për me i ekzekutu të gjitha pagesat, ndodh që deri në muajin qershor të mos paguhen. Ju mund të merrni vendime por nuk mund qdo her të ekzekutohen në kohën e caktuar. Ajo qka po e shoh në rend të ditës është shqetësuese sepse ka shumë kërkesa ju e dini buxhetin të cilin e keni miratu dhe mundeni me pas parasysh sa mundemi me i mbulu, sepse kemi dhe qështje të cilat janë të planifikuara për shpenzime të tjera.

**Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka dikush tjetër të shtojë, kalojmë te rendi i ditës. Kemi një propozim nga zyra e Kryetarit për futje në rend të ditës që është: Propozim për miratimin e vendimit të këshillit organizativ, për ndarjen e mirënjojheve konform nenit 9 të Statutit të Komunës së Malishevës. Të nderuar anëtar të Komunës së Malishevës, Këshilli Organizativ i formuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Malishevës, vendimi nr.02/235, të datës: 05.05.2023, pas shqyrimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit Organizativ, vendosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të Komunës së Malishevës, të nominojë këto personalitete për ndarjen e qmimeve të cekura si në vijimë: Këshilli Organizativ i propozon Kuvendit të Komunës së Malishevës për miratim: Për çmimin “ Imer Krasniqi” Këshilli organizativ vendosi që t’i dërgon në Kuvend popozimet e shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare dega në Malishevë;

1. Z.Fadil Elez Berisha nga fshati Berishë, KK-Malishevës,
2. Z.Shpejtëm Sinan Krasniqi nga fshati Damanek, KK-Malishevës.

Për çmimin “ Hamdi Berisha” për kontributin e dhënë në shkollën shqipe,

1. Z.Ilysen Bytyçi nga fshati Turjakë, KK-Malishevës,
2. Z.Haki Reshat Morina nga fshati Astrazup, KK-Malishevës ( pas vdekjes ).

Për çmimin “ Shpëtim Robaj” për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;

1. Dr. Lumni Samadraxha- Pediatër,
2. Z. Agim Morina Teknik i Farmacisë.

Kush është për që ky proozim të hyjë si pikë në rend të ditës?

Me vota unanime, ky propozim hynë si pikë e rendit të ditës.

29 anëtarë jemi prezent dhe kemi kourum për vazhdim të seancës.

Urdhëro, Astrit Sertolli!

**Astrit Sertolli: Përshtendetje për të gjithë!**

Para se me kalu në rend të ditës unë jam anëtar i Komitetit për Familje të Dëshmorëve dhe Veteranëve

të luftës, ne si kuvend e kemi miratu që me i pas 7 anëtarë ky Komitet, kisha kërkuar që sot me shi si pik të rendit të ditës me plotësu me dy emra të tjera. 5 anëtar janë dhe kemi kërkuar dhe dy anëtar për arsyet që e ka ky Komitet.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Materiali na ka ardhë me kohë mirëpo disa po vinë me vonesë. Mbrëmë është ardhë prapë raporti i Kryetarit të cilin nuk kam mundur ta shikojë nuk e di çka është ndryshuar. Pika e dhjetë vendim për pagesën e anëtarëve të Komisioneve dhe Komitetet jo obligative të themeluara nga Kuvendi i Komunës, unë kërkova në material që nuk ka asnjë vendim, kisha kërkuar një sqarim te kjo pikë.

**Argjend Thaçi:** Është propozim vendim të cilin do ta marrim sot.

Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Përvendetje për të gjithë!

Propozimi i Amrushit nuk u hidh në votim, i cili ishte i pari prej të gjitha propozimeve.

**Argjend Thaçi:** Ai ishte jashtë rendit të ditës, jo në rend të ditës. Të gjithëjeni të hapur për propozime. E hedhim në votim propozimin e Astritit për shtimin e dy anëtarëve të rinjë në Komitetin për familje të Dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës. Kush është për?

Për: 27,

Kundër: 0,

Abstenime: 2.

Me 27 për, 0 kundër dhe 2 abstenime ky propozim hynë si pikë e rendit të ditës.

Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani:** Përvendetje për të gjithë!

Propozoj që të hyjë në rend të ditës kërkesa e datës: 27.03.2023 nr.02/160, është kërkes për ndihmë financiare për një fëmijë dy vjeqar nga fshati Lladroc. Ka nevojë urgjente për ndihmë financiare.

**Argjend Thaçi:** Kush është që kjo kërkesë të hyjë në rend të ditës?

Me vota unanim, ky propozim hynë si pikë në rend të ditës.

E hedhi në votim si tërsi rendin e ditës. Kush është për këtë rend ditës të propozuar me ndryshime dhe vërejtje?

Unanimisht, konstatoj që miratohet rendi i ditës.

**Pika e parë** është: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të rregullt, e mbajtur me datë: 30.03.2023. A keni ndonjë kritik apo ndonjë vërejtje?

E hedhi në votim, kush është për miratimin e procesvërbalit?

Unanimisht, miratohet procesvërbali i mbledhjes së tretë.

Pika e dytë është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës (Janar-Dhjetor) 2022. Për ta prezantuar këtë pikë e kemi Kryetarin e Komunës z.Ekrem Kastrati.

#### **Ekrem Kastrati: Përshendetje për të gjithë!**

Në mbështetje të Ligjit për qeverisje lokale të Statutit të Komunës dhe planit të punës për vitin të cilin e kemi lënë pas, kam nderin që sot para jush të paraqes raportin e punës për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Këtë raport keni pasur mundësi ta keni të gjithë para jush si material të zgjeruar i cili paraqet punën një vjeçare, të arriturat e punës dhe sfidat të cilët jemi ballafaquar të gjithë ne gjatë kësaj periudhe që i përket ky raport vjetor. Para se të kalojm te disa pika kyqe të raportit dua të theksoj se viti 2022, sikurse për çdo komunë dhe për komunën tonë ka qenë një vit i vështirë, për arsyet e pasojave të cilat i shkaktoj periudha pandemike. Megjithëatë arritëm që ta realizojmë punën dhe të gjitha aktivitetet tona konform planit të punës për vitin 2023.

Si Kryetar i Komunës jam teje i kënaqur me punën, sukseset dhe arritjet nga qeverisja jonë e përkohshme Komunale, dhe jam shumë mirënjoës nga Drejtoret dhe gjithë administratës Komunale që në përgjithësi kan qenë duke punuar zellshëm që qytetarët e Komunës së Malishevës të ju ofrojmë shërbime cilësore të cilët ata me të vërtet i meritojnë. Për vitin 2022 janë procesuar projekte të infrastrukturës publike si ndërtimi asfaltimi i rrugëve lokale, ndërtimi i trotuarëve në qytezë dhe në fshatra, ndërtimi i kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve, renovimi i objekteve të shkollave fillore dhe të mesme, ndriqimi publik, investimet në shëndetsi, arsim, bujqësi, sport, kultur dhe mirëmbajtja e kanalizimeve të ujравë të zeza në fshatra dhe qytezë. Projektit e infrastrukturës publike të realizuara në vitin 2022 janë si më poshtë:

- Ndërtimi i asfaltimit 25.82km rrugë lokale,
- Ndërtimi i rrugës kryesore “Ibrahim Mazreku” nga ura deri te hymja e ambulancës (faza e parë) l=1300m
- Renovimi dhe mirëmbajtja e 5.29km të kanalizimeve të ujравë të zeza në fshatrat e Komunës (projekt tre vjeçar)
- Ndërtimi i trotuarëve në gjatësi prej 3.3km
- Ndërtimi i aneksit të objektit të shkollës fillore në fshatin Marali dhe renovimi objekteve shkollore nëpër fshatra.
- Ndërtimi i tri fushave sportive në fshatrat Guriq, Berishë dhe Stapanicë.
- Ndriqimi publik dhe renovimi i tyre nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës.
- Renovimi i objektit të gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë me programin e efiqencës.
- Punimet në stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë
- Trajtimi i deponive ilegale në territorin e Komunës së Malishevës
- Ndërtimi i garazheve në QKMF (vazhdim), renovimi i objektit të QKMF-së dhe rregullimi i oborrit pullazit dhe rethojës
- Ndërtimi i aneksit të qerdhës në Malishevë dhe ndërtimi i qerdhës së fëmijëve në fshatin Kijevë
- Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve urbane dhe lokale

- Ka vazhduar ndërtimi i zhveshtoreve dhe tribunave në stadiumin e qytetit, ku është duke u punuar
- Është hapur konkursi për Projektin Arkitektonik dhe Urbanistik për “Ndërtimin e Sheshit së bashku me parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës” i cili konsiderohet si projekt më i madh i realizuar në Komunën e Malishevës.
- Është kontraktuar ndërtimi i rrugës që nis nga shkolla profesionale Qendra e Kompetencës rruga “Habib Berisha” që kalon ka restorant “Princesha Palace” që lidhet me rrugën e unazës së qytetit deri te stadiumi i qytetit “Liman Gegaj”
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është lidhur kontrata për renovimin e objektit të vjetër të shkollës fillore ”Naim Frashëri” në Banjë, që do të shërbej si qerdhe për fëmijë
- Kemi përkrahur qdo familje e cila ka pasur dy student në arsimin e lartë me një bursë prej 300E
- Kemi përkrahur fermerët përmes pagesave direkte ata të cilët dorëzojnë qumështin në pikën grumbulluese me 0.03 euro për litër të qumështit si dhe fermerët me sera

Publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raportet rreth inkasimit dhe të hyrave vetanake komuna jonë është duke u ngritur lartë në raportet e organizatave ne monitorimin e qeverisjes në nivel lokal. Më lejoni të theksoj që gjatë periudhës reportuese Janar-Dhjetor të hyrat vetanake në Komunën tonë kanë shenuar një progres të jashtëzakonshëm duke i tejkaluar dhe planifikimet tona, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është 127.83%. Shkalla e realizimit të bugjetit për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 99.74% kurse përqindja e tërësishme e bugjetit e shpenzuar në këtë periudhë është 99.16%.

Gjatë vitit 2022 kemi nënshkruar dhejtëra marrëveshje bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, dhe ky bashkëpunim ka shënuar një progres me avancimin e shërbimeve ku tani Komuna e Malishevës është partnerë në shumë projekte që janë në proces të implementimit. Gjithashtu në këtë raport janë të listuara dhe të detajuara disa nga fushat kryesore të angazhimit të ekzekutivit gjatë vitit 2022, Diskutimet publike dhe bashkëpunimi me qytetarët, Furnizimi me ujë të pijes në tërë territorin e Komunës së Malishevës, Mirëmbajtja e mjedisit, Përkrahja e familjeve me kushte të rënda ekonomike, Bashkëpunimi me institucionet qendrore, Bashkëpunimi me partnerët dhe donatorët vendorë e ndërkombëtar, Realizimi i Planit të Punës sipas Drejtive. Kjo ishte një hyrje e shkurtër e raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2022. Raportin e zgjeruara e keni në duart e juaja, para se të fillojmë diskutimet për këtë pikë dua të ju ceki që objektiv kryesore e jona është që qeverisja jonë dhe e partnerit tonë qeverisës është qeverisja transparente, llogaridhënëse dhe mbi të gjitha e ligjshme.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Kryetar për prezantimine këtë raporti, hapi debat rreth kësaj pike.  
Urdhëro, Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Furnizimi me ujë të pijes në territorin e Komunës së Malishevës, e pash raportin që keni pasur takime me Gjakovën, me institucione qendrore në Prishtinë, është formu një komision që

është në teren për vendosjen apo zgjidhjen e qështjes së ujit në Komunën e Malishevës, sa është duke u punuar tani, sepse shumica e fshatrave jan ende pa ujë të pijes. Sa jeni duke punuar në këtë drejtim që Komuna jonë të mos ketë asnje problem më?

Energjia elektrike-ju kisha kërkuar Kryetar të punoni sa më shumë në atë drejtim, e pashë që paski pasur takime mirëpo gjithmonë kanë dështu, kisha kërkuar të mos ndaleni ne jemi këtu do të ju mbështesim për çdo penges që ju hasni.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesë Kastrati!

**Agnesë Kastrati:** Përshendetje për të gjithë!

Kryetar, faleminderit për raportin!

Dua të cek i që raporti është shumë i kompletuar, dhe ndoshta ka qenë ndërherat e para që më është dukur një raport që ka ardhë në Kuvend Komunal i pranueshëm dhe siç i ka hipe një raporti. Te disa pjesë të raportit do të duhej më shumë të dhëna, përsimbull te pjesa e urbanizmit: Ndriqim publik dhe renovim në përfshira, është dashur të ceket në cilat fshatra ka qenë renovimi dhe ndriqimi publik.

Qështja kryesore është furnizimi me ujë, ne e dimë që një prej zotimeve kryesore që ka ardhë në pushtet Kryetari Kastrati ka qenë zgjidhja e problemit furnizimit të ujit të pijes. Do të duhet më detajisht të na tregosh qfarë ke bërë në këtë drejtim.

Kjo nuk përfshihet në raport por unë e di që Kryetari ka nënshkruar dhe dy marrëveshje bashkëpunimi me Hidroregjionin Jugor, dhe do duhet që me na tregu qka konkretisht përbajnjë këto marrëveshje dhe deri në fund të mandatit a ka me u zgjidhë kjo qështje apo jo?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** E kam lexuar raportin dhe dua t'i cek i disa qështje më kryesore që unë mendoj që dojnë diskutim dhe debat më të gjerë. Janë tri qështje që e prekin interesin e qytetarëve dhe nuk kemi parë ndonjë intervenim konkret prej anës së qeverisjes lokale.

E para ka të bëjë me trajtimin e ujrave të zeza, mos funksionimi i tyre, bllokimi i kanalizimeve ka që nuk janë të lidhura me kanalizimin dhe mendoj që është momenti i fundit me pas një fokus të qeverisjes Komunale të Kryetarit për trajtimin e këti problemi dhe pastrimin e lumit Mirusha.

Pastrimi i mbeturinave ne e kemi një kompani që e bënë pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave mirëpo nuk ka fshat që nuk kemi deponi të ilegale të mbeturinave. E kemi diskutu disa herë në kuvend këtë qështje por ende nuk është ndërmarr asgjë.

Qështja e ujit të pijes që disa kolegë e cekën, është shumë shqetësuese kjo qështje mendoj se duhet me qenë më ngulmues dhe shumë më insistues qoftë përmes projekteve qoftë prej grandit qeveritar, qoftë prej investorëve të huaj.

Qështja tjetër është bashkëpunimi me KEDS-in, i kemi fshatrat prej Banjës e që përfundon te Berisha janë me rrjet të viteve 60-70-ta nuk i ndërron asnjë shtyllë. Duhet me pas një bashkëpunim, nëse ai operon në Komunën tonë nëse nuk po i përfundon shërbimet ne si Kuvend duhet me i vendos taksa dhe duhet me zgjidhë këtë qështje.

I pashë të arriturat e Drejtorive, në raportin e Drejtoris së Inspektoriatit sheh të hyra minimale nga kjo drejtori, ose nuk është duke e përfunduar punën siç duhet Inspektorati ose po bëhet zemërgjerë dhe po i lejon me vepru siç po dëshirojnë. Ka biznese që nuk e respektojnë orarin e punës për punëtor, ka punëtor që punojn me 12-13 orë, a i ka të regjistruar apo nuk i ka, shet mall pa afat që i publikojn dhe mediat portalet lokale, kur arrin portali me pa mallin me afat të skaduar përsë nuk arrin inspektori me pa.

Te Drejtoria e Bujqësisë ka një disiplin pak më të madhe për mënyrën se si i qaset trajtimit të kësaj fushe, mirëpo vërejtje për ta është se po vazhdon prerja masive e pyjeve ne jetojme në rajonin e maleve të Berishës i sheh çdo ditë qytetar të pa ndërgjegjshëm të cilët i shkatërrojnë pyjet dhe nuk ka ndonjë gjobë.

Për qështjen e Drejtoris së Arsimit është momenti i fundit Drejtoreshë me trajtu seriozisht qështjen e Drejtorëve të shkollave.

Te qështja e shëndetsisë më ka ardhë shumë mirë që janë bërë këto investime në këto hapsira, mirëpo nuk po përkthehet i njejtë sistem dhe te shërbimet që po bëhet. E kam parë konkursin e fundit të cilat i kemi dhënë vërejtjet dhe nuk dua të i përsëris. Problemi është që nuk po e kemi Drejtorin këtu të i shprehim shqetësimet tona, të kishte qenë këtu besoj i kish përmisu këto gjëra në bazë të vërejtjeve tona.

I kam parë që janë disa investime të cilat bëhen së bashku me nivelin qëndror por pastaj postohen në Ueb-faqe të Komunës që vetëm Komuna i ka bërë. Këto projekte të cilat bëhen në bashkëpunim Kryetar mendoj që duhet me u taku më seriozisht dhe me qenë më ngulmues në këtë bashkëpunim. Çka kam parë në stadium që kam qenë herën e fundit ish shkatërruar fusha dhe asnjë ulëse nuk e kish, ne po i japim buxhet nga Komuna mirëpo objektet nuk po i mirëmbajnë është shqetësuese kjo gjë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Faleminderit Kryetar për raportin, është një raport mjaft përmbajtësor. I kam disa pyetje është fjala te projekti i ujësjellsit e cekën dhe kolegët, por dëshirora të di a jeni ende në kontakt dhe deri në qfarë faze keni arritë ju me Komisionin dhe me Ministrin.

Qështja tjetër në Komunën e Malishevës ka shumë familje skamnore sigurisht keni ndihmu me pako ushqimore, sigurisht ju keni nda dhe mjete financiare për raste të ndryshme, mirëpo do të ishte mirë dhe transparente të bëni publike listat për arsyen se indeksi i transparencës nuk është dalë mirë si Komunë e Malishevës.

Kompania e pastrimit Ekoregjioni- vite më parë ka qenë një marrëveshje apo një fond përmes Bashkimit Evropian dhe Ministris së punës dhe mirëqenies sociale të cilët i kanë angazhu disa punitore shtes në përfshirat për me pastru ambientin, mirëpo kjo më shumë ka dhënë mesazh vetëdijesuse sesa puna që është bërë. A ka ndonjë mundësi me praktiku dhe tash aty ku është më se e nevojshme në disa fshatra me caktu ndonjë punëtor shtes, qoftë me forma përmes prokurorimit apo ju e dini në cilat forma?

Cili është rapporti dhe sa ju ndihmoni me mjete financiare kompanive në këtë rast kompanis së Hidroregjionit Jugor dhe kompanis EKO regjionit?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Faleminderit Kryetar për raportin, sigurisht që pjesën dërmuese të këtyre pikave që ne do t'i ngrisum shumica prej kolegëve i cekën. Sigurisht që uji i pijës është gjëja kryesore për Komunën, e keni pasur dhe zotim alektural që ujin nga Radoniqi me sjelli këtu dhe do të hiqet dilema përgjithmon, mirë është të fokusoheni në këtë drejtim. Ne ju mbështesim në këtë projekt të madh. Rryma elektronike ndoshta jemi të paktit në nivel të Kosovës që jemi më së keqtë me rrymë. Te mjedisi kisha pas dëshirë që mjedisi me qenë më i pastër në të njëjtën kohë duke u ndërlidh dhe me inspektoriatin që të mos kursethet me gjoba.

Te menaxhimi i mbeturinave nuk e di në cilën fazë është por megjithëatë ne jemi dëshmitar që ku do që të shkojmë ka mbeturina, si mbeturina inerte ashtu dhe mbeturina jo inerte. Mendoj që është mirë me bërë një skanim të gjendjes dhe të intervenohet aty ku është më shumë e nevojshme.

Te përforma është një pjesë e rrjetit që shkon deri te ardhja e tregimit të përformancës, më ka ardhë keq që nuk jemi përfitues të grandit të përformancës, sepse të paktën fitojnë qytetarët. Është mirë me pas kujdes në cilat pjes kemi ngecje që ne të dalim më mirë dhe të sillen ato mjete të investohen në Komunë.

Te insektoriati, është shqetësuese Drejtor që ka pak gjoba ne e dimë qysh është gjendja në Komunë, në fshatra e ki mandatin vepro sepse duke punuar formojmë rend dhe ligj, sepse gjoba është vetëdijësimë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit Kryetar për Raportin, raporti ka qenë vuluminoz jo vetëm në kontekstin sasior por dhe në atë përbajtësor. Kjo është një punë e jashtëzakonshme që brenda një viti është bërë në Komunën e Malisheës, vetëm nëse shkoni në rrugën "Ibrahim Mazreku" lirim i hapsirave publike nga objektet, nga shtyllat elektrike, të gjitha kabllot kishin qenë të kompanive të internetit vetëm një e rrymës, nuk e di a ka pas situat më të komplikuar ndonjëherë dhe të gjitha këto kanë kalu në një qasje tjetër në infrastrukturën nëntokësore të cilat i kanë dhënë një pamje të mrekullueshme asaj rruge.

Sa i përket investimeve të cilat janë bërë në Komunën tonë, Kryetari i ceki disa dhe disa nuk i ka cek por që janë në proces, ajo qka kisha kërkuar me ngut si procedurë është trajtimi i kolektorit të ujравe të zeza përfaktin se mjaftë investime janë duke u bërë në qytet dhë ato ujra duhet me u trajtu me shku deri në atë pikën ku ato nuk e pengojnë asnjë qytetarë.

U cekën dhe investimet në shëndetësi që ka marrë një pamje të jashtëzakonshme objekti dhe oborri të gjitha. Ka kërkesa të shumta Kryetar që ato biznese të cilat janë aty afér kryesisht ato biznese të cilat ofrojnë produkte farmaciotike të kenë mundësin me pas një qasje përveq hymjes kryesore, mirëpo e tëra kjo le të mbetet në autoritetin e juaj dhe ekipës suaj profesionale me vlerësu se a ja vlen kjo dhe cilia është mënyra për ta bërë këtë.

Një shqetësim tjetër të cilin e kanë ngrit disa prej bizneseve të cilët janë tanë në rrugën "Ibrahim Mazreku" ka shumë investime të cilat janë duke u bërë sidomos në krahun e djathë të rrugës me pas një mundësi më të lehtë në qasjen e rrugëve të tyre të cilat i kanë ato biznese, mirëpo me i pa mundësit më të përshtatshme të cilat nuk e cenojnë projektin dhe me ju kriju qasje sa më të lehtë për rrugë bizneseve.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Fillimisht faleminderit Kryetar për raportin!

Ky rapport është i formuluar mirë të përgëzoz. I ke pasqyru në report tentativat e ekzekutivit për zgjidhjen e problemit me ujë të pijes ka qenë dhe premtim i juajt qysh në fillim, por ende nuk kam parë diqka konkrete dhe sipas kësaj që shihet a e pranoni që ujësjellsi i Senikut është projekt i dështuar.

Figuron në report dhe kanalizimi në Kijevë por një metër kanalizim nuk është bërë, janë dy qështje të mëdha qështja e ujit dhe kanalizimit por përfatë të keq këtu dhe faktori njeri ka ndiku sepse vetëm për ujësjellës të Senikut rreth 2,000,000E janë shpenzu.

Fshatrat e bashkësis lokale të Kijevës janë më së keqi në këtë Komunë, dhe ai projekt që është formuar është totalisht i dështum dhe gypat të cilët janë shpërndarë asnjë gyp në dy lagje të Kijevës nuk janë vendos, është fjala përrugën “Demush Gashi” dhe rrugën “Rizah Gashi” janë afér 600m.

Sa i përket te shëndetësia, ju kisha lut kolegëve me pa rapotin në faqe 15 kam kërkuar me u bërë shpërndarja e investimeve në shëndetësi, është mirë që po ndodhë e kam ngrit qështjen në këtë foltore që Kijva si QMF ka nevojë për investime. Vetëm shikone reportin i ka 15,000 pacient dhe kushtet elementare nuk i kanë përpunu. Tani i keni sjell ni staf adekuat apo jo nuk i vlerësoj sepse nuk jam profesionit përkëtë punë, aty ka nevojë për investime kapitale të paktën të marrin shërbime elementare shëndetësore.

Qenka dhe Drejtori i Kulturës këtu kemi pasur premtimet për ndërtimin e Kullës të veprimtarit “Ramadan Shabani”, është mandati i dytë dhe as në procedurë nuk është. Kulla e Rifat dhe Tahir Berishës në Berishë, konsideroj që këto janë figura që duhet me u mburr, por në këtë aspekt nuk është ndërmarr asgjë. Të paktën iniciioni procedurat, sepse jemi të bindur që keni me gjetë pajtim me Ministri të Kulturës.

Dhe një gjë që lidhet me reportin e prokurorimit disa kode të cilat po i fusni psh. renovimi dhe kanalizimi në Kijevë në dy vende e shoh 50,000.00E-60,000.00E po flas përvitit e kaluar Kryetar por asnjë metër kanalizim nuk është bërë. E ka trotuari Kijevë-Banjë 30,000.00E por asnjë kubëz nuk është vendos është mirë këto gjëra me i pas parasysh me pas kujdes. Për shpenzim të buxhetit që ka bërë Komuna dhe ne i gjëzohemi kësaj por duhet me pas kujdes në strukturen e shpenzimit dhe të investimit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valjeta Hoti!

**Valjeta Hoti:** Faleminderit Kryetar për raportin!

Unë dua të ndalem te Drejtoria e Shërbimeve Publike te pilot projekti nr.4 ku keni cekë që kemi mbikëqyrë mirëmbajtjen e ndriqimit publik në afat tre vjeqar, 2022-2024. Konsideroj që diqka e tillë nuk ka ndodhë të paktën jo në atë masën të cilën e keni menduar ju dhe sa është dashur të bëhet në këtë aspekt, dhe periudha kohore e cila është e cekur këtu nuk përpuset me atë që vazhdimisht është kërkuar të bëhet mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e ndriqimit publik. Çdo herë e kemi marrë përgjigjien që ne e kemi një kontrat me një kompani që rrallë e kemi pa në teren, në shumicën e fshatrave banorët po e bëjnë veitë rregullimin e ndriqimit publik.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Kryetar!

**Ekrem Kastrati:** Uji, ne çdo ditë ballafaqohemi me probleme të ujit sepse çdo ditë trokasin qytetarët në zyën time për mungesë të ujit, pra nuk jam i kënaqur asnjëher me punën që është bërë deri më tash lidhur me realizimin e këti projekti, por kemi bërë maksimumin që është e mundur. Ky projekt është kompleks sepse burimet të cilat i kemi në territor nuk garantojnë ujë 100% kundër nevojave të cilat i kemi. Ne duhet të kërkojmë ujin jashtë territorit të Komunës së Malishevës, mundësia më e madhe është liqeni i Radoniqit, në fillim të mandatit kam kontaktuar me zyrtarët e kompanis KRU Gjakova të cilët janë në menaxhim të liqenit të Radoniqit. E kemi bërë një projekt të cilin kemi kérku se si është e mundur që ky projekt të realizohet. Ky projekt është kompleks, sepse kalon prej një territori të Komunës në territor të Komunës tjeter, kjo rrugë kërkon privatizer, kërkon frekondimin e Komunës tjeter për me vepru për me kalu atje. Këtë nuk mundem me bërë pa mbështetjen apo suportimin e Qeveris përkatesisht Ministris së zhvillimit ekonomik. Ne kemi gjetur një bank e cila na dha kredi e që kamata kanë qenë jashtëzakonisht të mira, ajo qka është dashur ka qenë një letër suportuese nga Minsitri i financave dhe i kam kërkuar Ministrin ndihmë, por kam marrë përgjigjje negative. Kam kërkuar dhe nga Kryeministri Kurti por dhe nga ai kam marrë përgjigjje negative.

Marrëveshjet me ujësjellsin sigurisht ne i kemi disa marrëveshje mirëpo marrëveshjen përrugën "Ibrahim Mazreku" është dashur patjetër të vendoset gypi i ri sepse gypi aktual ka qenë shumë i vjetër. Ujërat e zeza, jo vetëm Komuna e Malishevës por të gjitha Komunat ballafaqohen me këtë sfidë ne po bëjmë maksimumin që të i trajtojmë këto ujëra të zeza ndërsa bllokimi i tyre është përgjegjësi e ndërmarrjes Ekoregjioni. Të gjitha këto ujëra derdhen në ujin e Lumin Mirusha nuk do të shkojnë dhe dy javë dhe kontaminimi i ujrave të zeza do të bëhet në ekstrem, për këtë arsy deri sa ne nuk gjemë fonde që të bëjmë fabrika për pastrimin e ujrave të zeza sidomos në kolektorin kryesor qdo përpjekje për me i qit ujrat e zeza në Lumin Mirusha dështoje, prap jemi në kontakt me disa donator.

Trajtimi i mbeturinave sigurisht që dhe neve na shqetëson po bëjmë përpjekje maksimale, një kontrat të cilën e kemi bërë që të i trajtojmë këto mbeturina por prap po e ceki që ne së bashku të i ndihmojmë njëri tjetrit për vetëdijësimin e qytetarëve. Rrugës përrugën Burim e kemi bërë një pastrim por mbas dy javë kanë hudhë prapë mbeturina, është në pyetje vetëdijësimi i qytetarëve.

Bashkëpunimi me KEDS kemi shumë probleme të jashtëzakonshme me rrjetin në fshatra të cilën e kanë të vitit 1975 sipas arsyetimit të tyre që Komuna e Malishevës ka investuar 3.2 milion gjatë viteve të kaluara edhe ajo pjesë është në projekte, por për arsyet e ngritisë së qmimeve të rrymës është dashur që ti ndaloj investimet jnë teren jo vetëm në Komunën e Malishevës por dhe në Komunat e tjera.

Inspektorati, dhe kjo drejtori po mundohet por kemi qenë shumë të angazhuar në rrugën "Ibrahim Mazreku" kemi pasur shumë punë shumë aktivitete, i kemi liruar pronat publike dhe kemi pasur angazhime deri në 18 orë në ditë.

Shërbimet në shëndetësi mendoj që kemi bërë investime të jashtëzakonshme kemi rrit numrin e puntorëve i kemi punësuar afér 30 punëtor.

Listat publike ne i kemi pasur parasysh por për arsyet e ndjeshmëris dhe për arsyet se mos po shkelen të drejtat e privatësisë prandaj dhe nuk i kemi paraqit në raport.

Te përforma vetëm 6 komuna në Republikën e Kosovës kanë mundur ta kalojnë në vitin 2021, ndërsa përrugën 2022 ende nuk ka përfunduar përforma jemi në përpjekje që ta përmisojm dhe ta

realizojmë më shpejt.

Sa i ndihmoni Kompanit publike? EKO-regioni dhe Hidroregioni janë dy kompani të cilat nuk janë në nivel të detyrës së tyre për arsyet e shumë nelizhencës, pakujdesis dhe gjëra të tjera negative, kam bërë shkres që të shkarkohet tërsisht menaxheri dhe të punësohet menaxhmente të reja.

Financiarisht i kemi ndihmu dhe ta shohim tani e tutje se si do i zgjedhim problemet tona.

qendra familjare në Kijevë ne kemi kontakt e qeverinë e Katarit që të bëjë një investim të përbashkët ku Komuna do të investoj 22% kurse pjesën tjetër ta investoj qeveria e Katarit, gati jemi në mbyllje të këti procesi por ende nuk kemi një finalizim.

Kullat sigurisht që këto janë trashegimit tona historike do të bëjmë përpjekje maksimale por deri më tash nuk kemi filluar procedurën për arsyet e mungesës së buxhetit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** U diskutua dhe u vlersua maksimalisht raporti i punës së Kryetarit Kastrati dhe qeveris Kastrati. Dhe unë vlersoj që ky raport është i kompletuar dhe vetëm dua ti ceki disa projekte ku qytetarët i marrin çdo ditë shërbime në projektet të cilat janë realizu: Renovimi i QKMF-së, Renovimi i Ghimnazit në Malishevë dhe në Kijevë, shërbimet e varrimit, largimi i deponive ilegale, transporti i nxënësve në fshatra, hapja e drejimit të mjeksisë në Kijevë, përkrahje të bujqësive, përkrahje të organizatave rimore, kulturore dhe sportive, bursa komunale për student. Do të kërkoja nga Kryetari Kastrati dhe Drejtoresha e DKA-së që të kenë parasysh dhe të ndajnë për këtë vit dhe 50 bursa për nxënës të shkollave të mesme të cilët janë me sukses të shkëlqyeshëm, kjo me qenë një përkrahje dhe një motivim shthes për këta nxënës. I gjëzohemi realizimit të këtyre projekteve.

**Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka askush për diskutim e mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë te pika tjetër e cila është kërkes nga zyra e Kryetari: : Propozim për miratimin e vendimit të këshillit organizativ, për ndarjen e mirnjohjeve konform nenit 9 të Statutit të Komunës së Malishevës. Të nderuar anëtar të Komunës së Malishevës, Këshilli Organizativ i formuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Malishevës, vendimi nr.02/235, të datës: 05.05.2023, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit Organizativ, vendosi që në pajtim me nenin 9 të statutit të Komunës së Malishevës, të nominojë këto personalitetë për ndarjen e qmimeve të cekura si në vijimë:

Këshilli Organizativ i propozon Kuvendit të Komunës së Malishevës për miratim:

Për çmimin “Imer Krasniqi” Këshilli organizativ vendosi që ti dërgon në Kuvend popozimet e shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare dega në Malishevë;

1. Z.Fadil Elez Berisha nga fshati Berishë, KK-Malishevës,
2. Z.Shpejtim Sinan Krasniqi nga fshati Damanek, KK-Malishevës.

Për çmimin “Hamdi Berisha” për kontributin e dhënë në shkollën shqipe,

1. Z.Hysen Bytyçi nga fshati Turjakë, KK-Malishevës,
2. Z.Haki Reshat Morina nga fshati Astrazup, KK-Malishevës ( pas vdekjes ).

Për çmimin “ Shpëtim Robaj” për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;

1. Dr. Lumni Samadraxha- Pediatër,
2. Z. Agim Morina Teknik i Farmacisë.

Urdhëro, Agnesë!

**Agnesë Kastrati:** Unë po flas në emër të grupit të VV-së me siguri komisioni që është votuar të cilët i kanë propozuar këta emra të nderuar, siç po shihet janë të gjithë burra sepse të gjithë emrat e proozuar janë të meshkujve për këtë jam shumë kritike, sepse ka shumë gra të cilat kanë dhënë kontribut të gjatë si në fushën e arsimit dhe në atë të shëndetësis. Kështu që për ne është e papranueshme kriteri parë, sepse janë të gjithë meshkuj, unë propozoj që për qmimin “Shpëtim Robaj” për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësis, propozimi i parë që është Dr. Lumni Samadraxha të cilin unë personalisht nuk e njoh dhe nuk dua ta paragjykoj, por propozojmë që ta zëvendësojmë me Mendehie Paqarizi, e cila është një motër medicionale e cila punon prej vitit 1989 kontributi i saj besoj që është i njohur. Ajo dhe aktualisht ushton punën e motrës medicionale dhe punon së bashku me pediatrin Dr. Gëzim Krasniqi. Për arsyre të kontributit është mirë me e përfshi dhe kërkoj me u votu prej kolegëve.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Këshilli organizativ për ndarjen e qmimeve i ka aprovuar disa emra por qëllimi im ka qenë i quartë, unë e kam dhënë aprovimin te qmimi për trimëri dhe heroizëm e kam mbështet për të dy kandidatët, te qmimi “Hamdi Berisha” unë i kam dhënë dy propozime dhe prapë qëndroj mbrapa saj, ndërsa te qmimi për shëndetësi “Shpëtim Robaj” unë kam abstenu te rasti në fjalë që e ceki dhe kolegia është fjala për Lumni Samadraxha një personalitet që ne nuk po e njohim. Agim Morina e kam mbështet dhe unë të gjithë e njohim dhe e dim kontributin e ti para lufte, gjatë lufte dhe pas lufte. Grupi i PDK-së i mbështet këto: Qmimi për veteran “Imer Krasniqi” i mbështesim, qmimin për “Hamdi Berisha” nuk i mbështesim dhe te qmimi Shpëtim Robaj vetëm Agim Morinen e mbështesim. Kisha kërku që secilin kandidat të hudhet ndaras në votim.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Për këto pika kaq të rëndësishme do të duhej të vinte materiali secilit asambleist, jo vetëm shefave të grupeve. Sa i përket qështjes së propozimeve dhe unë pajtohem me para folësen, sepse me të vërtet nuk po duket e mirë për Komunën e Malishevës me qenë vetëm emra të meshkujve dhe mos me qenë dhe një femër. Ne si asambleist dhe përfaqësues të drejtëpërdrejt të qytetarëve se a do të kishim ndonjë propozim, mirëpo kur po e shikojmë se në qfar forma po vjen deri në këtë përfundim, atëherë nuk e kemi parë të arsyeshme me ardhë me ndonjë propozim të drejtëpërdrejtë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Ne si grup parlamentar i mbështesim propozimet e këtyre tri fushave të kontributit që është dhënë për qmimin për shëndetësi, për trimëri dhe në fushën e arsimit. Pothuajse për neve të gjithë janë të njohur dhe janë kontributdhënës. Pajtohem me Agnesën që e ceki ka dhe të gjinis

femrore që janë kontributdhënëse, ka dhe në lufta që kanë dhënë kontribut dhe ato duhet me u trajtu në mënyrë të barabartë, mirëpo konsideroj komisioni i shoqatave të dalura nga lufta i ka dhënë emrat më meritor dhe të gjithë ata të cilët e kanë marrë armën dhe ja kanë kthyer armikut e meritojnë nga një qmim, por kjo shkonë me radhi. Sa i përket grupit tonë ne e mbështesim komplet si propozim dhe si kërkesë të Kryetarit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Arlind Morina!

**Arlind Morina:** Unë kam qenë pjesë e këti Komisioni ne për hirë të unifikimit, gjithë subjektet politike që mos të kemi mosmarrëveshje këtu kemi shtyrë tri mbledhje që të dakordohemi, mendoj që këto kanë qenë kërkesa të drejtoreive përkatëse dhe të organizatave të dalura nga lufta unë kërkoj nga të gjitha grupet që mos ta qesim para aktit të kryer, sepse nuk është pika që ne duhet të bëjmë politik. Ka emra të tjer që meritojnë qmime, por mendoj që secili propozim që ka ardhë nga drejtorit përkatëse e kanë kontributin e vetë në secilën lami. Ne si LDK i mbështesim këto kërkesa dhe besoj që të votohet unanimisht.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Unë nuk pajtohem me Arlindin që e ceki para aktit të kryer, është kuvendi ai i cili i ndan këto qmime, kuvendi i voton. Pajtohem me Agnesën do të ishte mirë që të kishte dhe emra të femrave dhe Drejtoresha është vetë femër dhe është dashur ta gjejë një emër. Nuk po e paragjykojë asnjërin prej tyre të gjithë e meritojnë me marrë qmime por nëse janë 6 meshkuj të paktën një emër i femrës me qenë.

**Argjend Thaçi:** Arlind Morina ka kërkuar replik, urdhëro!

**Arlind Morina:** Veton, ju si grup është dashur të dërgoni një anëtarë femër në atë komisioni dhe atëherë ndoshta kishte mundur më shumë me mbrojt këtë temë. Dhe unë pajtohem që meritojnë me qenë të gjinis femërore jo vetëm një por dy.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Eqrem Morina!

**Eqrem Morina:** Pëershëndetje për të gjithë!  
Edhe ne si grup i AAK-së i mbështesim të tri propozimet e Kryetarit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Propozimet të cilat i kam dhënë në komision janë: Profesori i ndjer z.Haxhi Samadraxha që krejt jetën ja ka kushtuar arsimit. Nuk ka të bëjë asgjë me politik këtu, besoj të gjithë e njihni dhe ka dhënë kontribut më të madhë se këta të tjerët që janë në listë. Po ashtu kam propozuar Demush Krasniqi nga fshati Drenoc është një veteran i arsimit ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e arsimit. Këto janë dy propozimet e mia të cilat i kam dhënë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtoresha e Arsimit!

**Arbëresha Krasniqi:** Qështja e meritave në kontributin jetësor dhe njëkohësisht dhe profesional unë konsideroj që nuk përkon me gjini, që në këtë rast të gjithë emrat të cilët u cekën janë emra meritore, kurr nuk e them që nuk ka pasur një grua meritore. Sa i përket propozimeve të cilat kanë shkuar nga Drejtoria e Arsimit janë të dy emra mësues shumë të nderuar dhe ajo qfarë neve na ka bërë obligativ që të i dhurojmë një qmim apo një mirënjoje është gjendja shëndetësore të mësuesit në fjalë. Në të gjitha rrjedhojat analizat të cilat i kemi bërë kanë quar në këtë propozim. Kështu që ne kemi emra të ndershëm të Komunës së Malishevës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesë!

**Agnesë Kastrati:** Ju lutem mos i devijoni fjalët të cilat ne i cekëm, asnë emër të këtyre nuk e kontestova. Unë besoj që të gjithë këta emra kanë dhënë kontribut, por nuk është mirë për Kryetarin dhe për Kryesuesin që atë ditë me 16 Qershori me dal me 6 emra të burrave dhe me ju dhënë mirënjoje atyre, në arsim ki më shumë femra që kanë dhënë kontribut. Ne e dim që ka femra që kanë dhënë kontribut dhe në kohë të luftës dhe si ushtare e UÇK-së, por dhe në forma të tjera. Ne si VV i mbështesim këta emra me të vetmin ndryshim te qmimi i "Shpëtim Robaj" me qenë propozimi të cilin e ceka më parë.

**Argjend Thaçi:** E hedhim në votim kërkesën e Kryetarit 01/759 kush është për?

**Nebih Bibaj:** Vetëm një sqarim sepse kjo nuk është precedent, t'i duhesh me i kërku mendimet e grupeve parlamentare se në cilën formë po shkojmë a dëshironi me shku bllok apo me emra të ndarë. Nëse merr vendim kuvendi me shku bllok atëherë në rregull jem. Ka kërkes nga dy grupet parlamentare që dëshirojnë të shkojnë me emra të ndarë t'i nuk mundesh me ja mohu të drejtë.

**Argjend Thaçi:** E vendosim një herë propozimin e Kryetarit pastaj propozimet e juaja.

**Agnesë Kastrati:** Qfarë kuptimi ka me i vendos në votim në pakon pastaj me u rikthy prapë te propozimet tonë.

**Argjend Thaçi:** Këshilli organizativ kërkesën na ka sjellë në pakon. Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Kryesus, kjo qasje e juaja nuk është e pranueshme për ne, të kisha kërkuar të mos përsëritësh kësi gjëra. Unë kërkova të vendoset në votim secili emër nëse i marrin votat atëherë në rregull jemi. Mos na vendos para aktit të kryer.

**Argjend Thaçi:** Në momentin që nuk kalon propozimi i Kryetarit nga Këshilli organizativ atëherë mundemi me shku me emra të ndarë. Urdhëro, Hamit!

**Homit Lima:** Nëse ju kërkoni nga një, atëherë Komision nuk është dashur të formohet, unë kërkoj që të shkojë në pakon.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Të gjithë ne jemi dikushi dhe të gjithë ne e përsaqësojmë dikënd, të gjithë dimë me kuptu një rregull të kuvendit apo një rregullore të Kuvendit. Gjithqka që ne bëjmë këtu është thjeshtë demokratike i ki numrat kalon, nuk i ki nuk kalon. Unë kërkoj Kryesus që këto qështjet e votimit merri së pari propozimet e të gjithëve, nëse Kuvendi thotë që duhet me i votu në pako atëherë e merr miratimin e kuvendit, nëse kuvendi thotë një nga një i miratojmë një nga një. Qdo kërkes apo propozim nga kush do që vjen pa dashur me cenu autoritetin e Kryetarit, kuvendi ka të drejtë me shqyrtu dhe me ndryshu atë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Të kërkova ta vendosësh në votim që të shkoj në bllok apo një nga një, kuvendi e vendos këtë. Nëse i ki votat vazhdo me bllok nëse nuk i ki vazhdojmë një nga një. Kuvendi është përfundimtarja e Komisioneve nuk ka rëndësi a formojmë Komision, sepse kuvendi ka me votu.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Kryesus, së pari duhet të hedhen propozimet në votim të cilat bëhen nga anëtarët e kuvendit nëse nuk kalojnë vazhdojmë me propozimin e Kryetarit, sepse askush nuk e lakoj asnjërin prej emrave.

**Argjend Thaçi:** E hedhim në votim këtë pikë se a dëshirojnë të shkojmë në pako apo një nga një. Kush është për që votimi të shkoj në pako?

Për: 15

Kundër: 12

Abstenim: 0

Me 15 vota për, 12 kundër, 0 Abstenim votimi shkon në pako.

E hedhim në votim propozimin e Kryetarit kërkesa nr.01/759 kush është për?

Për: 16

Kundër:

1

Abstenim: 10

Me 16 vota për, 1 kundër, 10 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Shkojmë në pauzë .

Kalojmë te pika e radhës e cila është: Shqyrtimi i Planit vjetor të Prokurimit publik. Për ta prezantuar këtë pikë e kemi z. Nuhi Shala.

**Nuhi Shala:** Përshendetje për të gjithë!

Nga të gjitha prej këtyre kategorive, tani i kemi dy aktivitete kontratat përfurnizim dhe kontrata përpunë. Kontratat përfurnizime është pjesa kryesore që kem të bëjmë ne si komunë, prej të gjitha këtyre janë pasqyru aktivitete të cilat do të zhvillohen për këtë vit fiskal. Te pjesa e kontratave përpunë është 5,332,404.00E dhe nëse e keni buxhetin shihet që plani i prokurimit është i harmonizuar me buxhetin.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Nebih Bibaj!

**Nebili Bibaj:** Ky raport është ardhë me vones, në planin e punës së Kuvendit duhet me ardhë në fund të muajit Mars apo në Prill. Disa projekte te cilat kanë qenë të inkorporume në buxhet nuk janë të para pame për këtë vit me plan të prokurorimit publik rruga e cila e lidhë Banjën me Lladrocin nuk ishte. Një specifik të veqant që kisha pas dëshirë me pas kur flasim për projekte në fshatra me qenë me emra të rrugëve, sepse nuk po e dim se ku po shkojnë këto projekte. Është mirë me qenë emri i rrugës së caktume se dhe ashtu duhet të votohet në buxhet me specifika të veqanta.

Dua të di a janë të gjitha këto kontrata të kontraktume, a kanë fillu fazën e kontratave apo janë vetëm duke planifikuar për këtë vit?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesë Kastrati!

**Agnesë Kastrati:** Faleminderit z. Shales për këtë Plan të cilin unë e kam lexuar dhe i bashkohna kritikes së Nebihit që ky raport ka ardhë së paku 3 muaj me vones dhë pastaj nuk po mundem me quajtur as plan. Datat të cilat po i shoh në tabel janë data të parashikuara të punimit të prokurorimit, janë data të cilat tashmë kanë kaluar kështu që më shumë po duket si raport se një plan. Duhet me ju kthy me seriozitet kuvendit komunal dhe këto planifikime me ardhë me kohë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Unë e kam shqyrtuar Planin e Prokurorimit dhe dua të di për këto kontrata a kanë fillu me u zbatu a janë të parapara 6 muj apo janë dy vjeqare.

Mungojn dhe disa specifikime siç është furnizimi me veshmbathje është shuma shumë e lartë, po ashtuu furnizim me mobilie inventar një shifër shumë e lartë a janë për shkolla apo për qfarë.

Kontrata furnizim me kompjuter, kontrata është 20.650,00E a është për shkolla apo për Komunë? Furnizim dhe mirëmbajtja me E-kiosk a bëhet fjalë vetëm për një E-kiosk apo për dy sepse dhe këtu është shuma e lartë?

Furnizim me shujt nga niveli I deri në klasën e pestë, a ka fillu ky projekt sepse e di që njëherë është ndërpore.

Ndërtimi i serave unë e kam pyetur Drejtorin e bujqësisë a ka me pas me pas projekt për sera më ka thënë që nuk është e parapame por këtu po shenon shuma 39.472,00E të parapame. Është mirë me i sqaru këto gjëra.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Po më vjen keq që nuk isha prezantur kur e ka prezantuar Planin e punës së Prokurorimit z. Nuhi Shala, nuk kam dyshim që e ka prezantuar në mënyrën më të mirë të mundur. Ajo çka i dëgjova disa parafolës është te datat dhe aktivitetet. Plani i prokurorimit në radhë të parë e ka një dokument bazik që i paraprinë këti plani, është buxheti i Komunës. Buxheti i Komunës është i miratuar nga OMESI si asamble, datat apo disa pyetje që i parashtron Vetonit aty parashihet aktiviteti që ka me ndodhë, nuk është e specifikume në plan të prokurorimit dhe nuk specifikohet në cilën Drejtori apo për cilin sektor bëhet fjalë. Aktiviteti i prokurorimit ndahet në tri fusha kontratat e punës, furnizimet dhe shërbimet. Në buxhet jemi mundu me i dhënë përparsi investimeve kapitale e këto kategorit e tjera ndoshta i kemi lënë si asgjë, ku gjitha këto të cilat janë në planin e prokurorimit janë

në Buxhetin e Komunës. Ajo çka ju inkurajoj është që Plani i Prokurorimit aktivitetet të planifikuara të realizohen ashtu siç janë të planifikuara.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Ne kemi kërkuar që plani i prokurorimit të na vjen me kohë, që të na tregojnë neve si asamble se çka do të punohet në këtë vit fiskal. Dua të bëjë një pyetje ju e dini që në këtë kuvend keni kërkuara dhe përkrahjen time kur ka qenë qështja e bartjeve të të hyrave këtu. Po e shoh në plan ndërtimi i palestrës sportive në shkollën "Lazgush Poradeci" Kijevë 20.000,00E nëse ka mundësi një sqarim sepse ky projekt është duke u bartur në çdo scancë që nga viti 2017.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nuhi Shala!

**Nuhi Shala:** Zonjusha që tha më shumë po ngjan në raport se në plan të punës, planifikimi i tillë është planifikim në nivel Kosove ndryshe nuk mund të bëhet. A kemi kontrat në vazhdim, shumica e kontratave janë vazhdhu kemi tri vjeqare dhe dy vjeqare.

U cekë pjesa e kompjuterëve dhe paisjeve të tjera këto janë kontrata të cilat i ka marrë AQK-ja ajo i zgjedh operatorët, shumica e furnizimeve janë në kuadër të AQK-së.

Salla e sportit 20.000,00E janë për me fillu procedurën dy vjeqare kështu i kam marrë informacionet. Rruga të cilën e lidhë Banjën me Lladrocin ne nuk kemi kontrat për atë rrugë.

Kemi shumë artikuj me shumë furnizime të cilat janë në buxhet por nuk janë në plan të prokurorimit arsyёja është se ato shkojnë te mallra dhe shërbime jo te kapitali.

**Argjend Thaçi:** E mbyllim debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores përmenaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Malishevës. Për ta prezantuar këtë pikë e kemi zyrtarin e shërbimeve publike z.Naser Morina.

**Naser Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Besoj që e keni pranë vetës dhe e keni lexuar Draftin, unë ju kisha ftuar me votu këtë rregulllore sepse dhe ashtu jemi me vones dhe na duhet për projektin për implementimin e reformës përtaks komunale. Qëllimi i kësaj është implementimi i reformës së taksës, kthimin e kompetencës nga niveli i ndërmarrjeve publike në nivelin Komunal dhe qështjet e tjera që kanë të bëjnë në përgjithësi me shërbimet e mbeturinave.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Faleminderit Naser për Rregulloren, dua një sqarim përsë ka pasur rritje prej 4.5 ka shku në 5,5 është rrit pagesa.

**Naser Morina:** Kjo sigurisht e ka një bazë se përsë është rrit nga 4,5 në 5,5, ju e dini që dy vite jemi duke punuar me grupin e ekspertëve Japonez ata e kanë bërë një studim të sakt 99% të shpenzimeve të cilat i ka një ndërmarrje, inkasimi i të hyrave vjetore dhe shpenzimet vjetore të gjitha këto i kanë bërë një analiz, dhe rekomandimi i tyre ka qenë së paku 5 euro duhet me qenë tarifa me funksionu

kompania. Kompania ka borkhe dhe është shumë vështirë duke funksionuar rekomandimi i tyre që së paku 5 euro me qenë tarifa. Është një taks e ulët ka më shumë se 10 vite që është 4,5.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Në KPF e kemi cekë që ne nuk jemi prorritjet së këti qmimi, për arsyet se kemi vërejtje të theksuara prej Kompanis e cila nuk kanë ofru shërbim në mënyrën më të mirë të duhur, ajo qka kërkojmë ne në momentin që lidhet kontrata Komuna me Kompanit duhet me u specifiku dhe shumë qështje të tjera psh paisja me kontinier gjitha familjet, shtimi i kontinjerëve të cilët janë një numër shumë i vogël te banesat kolektive të cilat janë në qendër. Dhe një pikë të cilën e kemi diskutuar në KPF është skeptike që pronart e tyre punojnë në mërgim. Këtu e keni pas një kalkulim me njehsort elektrik, ndoshta duhet me marrë ndonjë model më të mirë sesa njehsort elektrik sepse ata e bëjnë një fakturë fiksë për arsyet të tatimit, ndoshta është më mirë me marrë modelin siç e ka KEDS-i.

Në kontrat të Komunës që do ta bëjnë me kompanit ndoshta është më mirë me diskutu dhe qështjen e mbetjeve të kafshëve.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Faleminderit Drejtoris së shërbimeve publike në bashkëpunim me gjakën Japonez të cilët kanë përgadit një Draft të tillë të kësaj rregullore, që konsideroj që ka qenë e domosdoshme ndoshta dhe më herët. Kam pak njohuri rrëth asaj që po pretendohet që niveli i menaxhimit të mbeturinave nga ndërmarrjet ndërkunale të kaloj në ndërmarrje komunale është përparësi për Komunën e Malishevës. Idea e kësaj që pagesën apo kësttin e mbeturinave që e paguajn qytetarët dhe bizneset të mos i paguhet më Kompanis por të i paguhet Komunës dhe Komuna e paguan Kompanin. Me këtë formë të organizimit ne si qytetarë kemi me qenë më të kënaqur, dhe kemi me pasur një adres më të sakt se ku kemi me i paraqit ankesat tona për grumbullimin e mbeturinave.

Komuna në kuadër të kësaj tarife e ka një pjesë që përfiton Komuna në emër të çdo klienti që e ka, ku krijohet një rritje e të hyrave komunale. Konsideroj që kjo është rruga më e mirë që Kompania nga ajo regionale me qenë kompani komunale dhe besoj që kemi me pasë një Malishevë më të pasur.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Desha të ju pyes Kryesus, a i keni bërë ftesë Drejtorit të EKO-regionit me qenë prezant meqë po prezantohet kjo Draft rregullore për mbeturinat dhe ambientin?

Kur është fjala te menaxhimi i territorit a do të duhej me qenë dhe përfshirja e fshatrave në këtë rregullore apo nuk ka nevojë? A janë të mbuluara të gjitha fshatrat me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave apo ende nuk janë futur të gjithë në menaxhim?

**Naser Morina:** Qëllimi i kësaj është rritja e kualitetit të shërbimit cilësia dhe mbulueshmëria, pastaj e kemi mbulueshmërin mbi 99% asnjë fshat nuk është pa shërbim. Në Rregullore nuk cekën fshatrat dhe te pyetja me qenë prezant drejtori i EKO-regionit ai ka qenë pjesë e grupit punues të këti Drafti është

pajtuar me të gjitha. Qështja e formulës diaspora shtëpit jo rezidente, kjo formulë është shumë standarde që i bie nga një euro në muajt nëse nuk jetojnë këtu, nëse jetojnë atë e dërgojnë me kartel financiare të rrymës nëse kanë mbi 15 euro shpenzim për një muaj ajo do të tarifohet në një taks tjetër sepse tregon prezencën.

E ceki Valoni që do të rriten të hyrat është e vërtet, por vetëm ekonomit familjare jo bizneset, bizneset do të kenë kontrat të vegant me Kompanit përkatëse, sepse dhe ashtu Komuna mirret vetëm me ekonomi familjare. Qëllimi kryesor është ofrimi i shërbimit më kualitativ dhe kthimi i kompanis në kuadër të Komunës.

**Alban Kastrati:** Po shihet që kjo Rregullore është bërë copy paste prej Komunës së Suharekës, një përmisim te dispozita përfundimtare pika dy, kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedur të njëjtë me atë të miratimit të kuvendit të Komunës së Suharekës, ndryshone këtë bëne të Komunës së Malishevës.

**Naser Morina:** Ndryshimi është bërë nuk e di a ju është dërguar juve nga zyra e Kryesusit. Është e vërtet që ne kemi bashkëpunuar me Komunën e Suharekës, Rahovecit dhe Dragashin ështëi njëjtë projekt.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Faleminderit për këtë Draft Rregullore, në seancën e kaluar i kemi votuar disa vende për grumbullimin e mbeturinave inerte dhe nuk po i shoh në Rregullore. Në cilin do vend që shkonë në fshatra të Malishevës ka deponi ilegale të mbeturinave të cilat nuk janë larguar. Ngritja e qmimit, shumë fshatra janë ngarkuar me borgje nga kompania edhe kurr nuk kanë ofruar fare shërbim, regjistrimi i klientëve është bërë në bazë të orëve elektrike prej vitit 2016 në këtë vit nuk janë mbledh mbeturinat ndërsa borgji ju ka faturu klientëve. Këtë qëshqje e kam ngrit kur kam qenë në Kompani në vizit dhe tani kan fillu qytetarëve me ju ardhë letra nga përmbaruesi.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Naser!

**Naser Morina:** Labinot, sa i përket kësaj pike nuk e di nëse ju ka ardhë materiali me ndryshime të cilën e kemi bërë është i shtuar një nen i vegantë i trajton të drejtat të rrënimive të objekteve të vjetra, do ta paguaj një taks të cilën do ta aproponi ju në të ardhmen ku janë tri lokacione të ndara e kemi trajtuar këtë qëshqje të klientelës dhe klientëve të rinjë ne jemi duke e përgaditur me një databazë sa më të saktë dhe duhet me bashkëpunu me tatimin në pronë dhe me gjendjen aktuale të klientëve nga Ekoregjioni dhe do ta bëjmë një dotabazë të mirëillt. Është problemi dhe te rexhistrimi i popullsisë dhe këtë problem e kanë të gjitha komunat te klientët, numri i ekonomive familjare.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Malishevës?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

28 anëtar jemi prezent.

Kalojmë në pikën tjetër e cila është: Shqyrtimi i Planit të punës së Drejtorisë për Bujqësi, për mbjelljet pranverore, për ta prezantuar këtë pikë kemi z.Sylë Dukolli.

**Sylë Dukolli:** Përshëndetje për të gjithë!

Plani në fillim është punuar në drejtorin tonë për mbjelljet pranverore, qe dy muaj nuk e di përsë nuk është futur në rend të ditës. Të mbjellurat pranverore kanë filluar në prill. Në vitin 2023 për të mbjellurat pranverore në komunën tonë janë planifikuar të mbjellura rrëth 1474hk për kulturat që planifikohen në këtë periudhë siq janë: Misri me 1100hk, miser sillazh 74hk, tërshër 115hk , elb afër 1360hk, kemi bimë surragjere në sipërfaqe 31hk, ndërsa për perimtari 80. Jemi bi palnifikim sepse e kam krahasuar me atë që kanë apliku për subvencione në ministri të bujqësisë të dhënat që i kam marrë nga sistemi do të thotë që vërehët një rritje afër 12%. Unë jam i kënaqur me punën në teren përveq motit të reshurave por faktori njeri është në nivel.

**Argjend Thaçi:** A dëshiron ndokush me marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo miratim kjo pikë nuk ka nevojë.

Kalojmë në pikën tjetër e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitet natyrore elementare në bujqësi në Komunën e Malishevës. Dhe për këtë pikë është Drejtori i bujqësisë z.Dukolli.

**Sylë Dukolli:** Pranvera e dini që nuk ka qenë e favorshme sidomos për pemtari për arsyetë dëmeve që i ka shkaktuar, vlersimi i dëmeve i bërë nga komisioni i propozuar nga Drejtoria e Bujqësisë, ndërsa i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje nga Remzi Paqarizi dhe Leutrim Kastrati dhe nga Drejtoria e Inspektoriatit Sahit Kafexholli, kanë përpunuuar një raport dhe kanë dëshmuan se në Komunën tonë janë dëmtuar kulturat pemtare si kumbulla, dardha, pjeshka, dhe molla. Me theks të veqant është molla dhe dardha, për arsyetë mos rezistimit të temperaturave të ulëta dhe ka ardhë deri te dëmtimi i tyre.

Gjatë vizitave në teren ky Komision ka bërë një procesvëral për secilin fermer që kanë pësuar dëme me përqindje, ju kam drejtuar ministris ku kam pasur një takim ata kanë ndërruar formën e kompenzimit të dëmeve dhe kanë kërkuar që të bëhet një raport nga Komisioni të bëhet procesvëral për secilin fermer dhe i njëjtë raport përpilohet sipas statistikave që kemi pasur për dëme në ministri të Bujqësisë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Drejtor faleminderit dhe për Komisionin dhe për punën që keni bërë. Po ndihna mirë që i keni dal në ndihmë këtyre, siq po shihet numri i fermerëve është 5 nuk kanë bërë kërkesa apo nuk keni mundur me i mbulu ky numër po më duket shumë i vogël.

**Sylë Dukolli:** Nuk kemi mundur me bërë thirrje ejani fermer ju që jeni dëmtuar, ne e kemi hapur thirrjen për me apliku ata të cilët janë dëmtu dhe ata të cilët e kanë kuptuar që fruti i tyre po bie në tok janë ardhë dhe kanë bërë kërkes dhe mbas disa ditësh e kam dërguar Komisionin që e kam formuara posaqërisht për këtë punë. Ata të cilët e kan pasur frutin të humbur 30% jemi sugjeruar që mos të i

marrin parasysh sepse 70% është e mjaftueshme me i nxjerrë shpenzimet e tyre dhe me pas shitje industriale të paktën.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valjetë Hoti!

**Valjetë Hoti:** Anëtarët të cilët e kanë bërë vlersimin në teren unë nuk i njoh personalisht, mirëpo sipas teje a janë adekuat sa i përket anës profesionale?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Sylë Dukolli!

**Sylë Dukolli:** Unë ju besoj janë ingjiniera të bujqësis, është fjala për Remzi Paqarizin e ka master të përfunduar, dhe është fjala për Leotrimin që është i drejtimit të njëjtë është zyrtar në Drejtorin time dhe mu ka kërkuar një ekonomist dhe ai është ardhë nga Drejtoria e inspektoriatit. Për nga ana profesionale këta të dy, sidomos Kryetari i Komisionit i cili është Remzia.

**Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka për diskutim e hedhim në votim, 20 anëtar jemi prezent. Kush është përkëtë pikë të rendit të ditës?

Unanimisht janë për.

Kalojmë te pika tjetër e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për integrimin e qëndrueshmë të personave të riadheshuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Malishevës. Për këtë pikë e kemi z. Edona Krasniqi mirëpo me leje sot nuk ka mundur me qenë pjesë. Është në kuadër të qeveris, strategji për vitin 2021-2025, rregullore nr. 22/2020 për ri integrimin e personave të riadheshuar, si dhe bazuar në rregulloren për integrime të huajve rregullore nr. 9/2019, për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 të qeveris me vendimin nr.01/110, datë: 11/07/2019. Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Përgjigjet i kam marrë në KPF prej Edonës dhe ka qenë shumë korrekte, ndoshta bëjmë përjashtim nga rastet tjera meqë kemi vendos që kur nuk është zyrtari adekuat me i shty pikat e rendit të ditës por meqë si grup parlamentare e kemi diskutuar në KPF dhe Rregulloren na ka dërguar ka qenë korrekte unë jam pro me kalu këtë plan të personave të riadheshuar sepse është vërejt që është në të mirën e qytetarëve tonë. Ka pak kërkesa që janë bërë nga qytetarët, kështu që për ne si grup jemi për me kalu kjo pikë dhe pa prezencën e Edonës.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kësaj pike?

20 anëtar jemi prezent, unanimisht janë për miratimin e kësaj pike.

Vazhdojmë në pikën tjetër e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me astësi të veçanta për vitin 2023.

Nga materiali i cili ju ka ardhë a keni ndonjë vërejtje, apo ndonjë sugjerim për shëndetësi?

Nëse nuk keni vërejtje e hedhim në votim, kush është për miratimin e kësaj pike?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shfuqizimi i vendimit nr.02/61 datë:07.02.2023, për listën e veqantë të pronave të paluajtshme të Komunës. Kush është për shfuqizimin e këti vendimi? Me vota unanime shfuqizohet ky vendim.

Kalojmë në pikën e radhës: Propozim vendim për pagesën e anëtarëve të Komisioneve dhe Komiteteve jo obligative të themeluara nga Kuvendi i Komunës. Urdhëro Valjetë Hoti!

**Valjeta Hoti:** Në bazë të këti vendimi pika nr.2 që është mbështetur në nenin I të këti vendimi, Komisionet dhe Komitetet jo obligative të formuara nga Kuvendi i Komunës të cilat i ke cekë cilat janë, Komitetit për barazi gjinore me vendim të kujt është themeluar të Prishtinës, Prizrenit.

**Argjend Thaçi:** Ai vendim është i vitit 2018 i mandatit të kaluar.  
Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** A përfshihet dhe Komitetit për barazi gjinore në pagesë?

**Argjend Thaçi:** Për këtë arsyе dëshirojmë me nxjerrë vendimin për komitetet dhe Komisionet jo obligative të formuara nga Kuvendi të ju bëhet pagesa. Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Disa Komisione ose Komitete të cilat nuk kanë qenë pjesë përbërëse të këti vendimi të cilat kanë qenë të themeluara nga ky Kuvend dhe për cilat nuk janë ekzekutuar asnjë pagesë, kërkoi që nga periudha të cilën e ka marrë mandatin kjo legjislatur gjithë ato Komisione dhe Komitete me u pagu në mënyrë retroaktive të mbështetura në vendimin që sot do ta miratojmë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Fjoralba!

**Fjoralba Kryeziu:** Përse Komiteti për Arsim është miratu për 12 muaj, por pagesa ka me u bërë për 6 muaj?

**Argjend Thaçi:** Ki të drejt sikurse Komiteti për Familje të Dëshmorëve i cili e shtojë numrin e anëtarëve.

Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Për Komisionet jo obligative të cilat paguhen për çdo mbledhje është vetëm i zgjedhjes së bashkësive lokale, përndryshe Komitetet jo obligative paguhen vetëm 6 mbledhje. Ti mundesh me i mbajt më shumë por paguhen vetëm gjashët.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e propozim vendimit që Komisionet dhe Komitete jo obligative të cilat formohen nga Kuvendi i Komunës të janë me pagesë?

Prezent jemi 23 anëtarë, me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika tjeter e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.08/503 datë:30.11.2022, e parashtruar nga Zijadin Paqarizi. Kemi të bëjmë për një kërkesë të kompenzimit të dëmit në bujqësi e kemi Drejtorin e Bujqësisë këtu i cili mundet me na arsyetu këtë kërkesë, Urdhëro Drejtor!

**Sylë Dukollı:** Kjo kërkesë është e datës 25.09.2022, fermeri Zijadin Paqarizi nga fshati Lubizhdë ju ka shfaqur një sëmundje e cila është tuberkulozi dhe ja ka vra gjithë bagëtin. Kjo fermë për momentin është shuar, një pjesë i është kompenzuar nga AVUKU, unë dhe atë her kam kërkuar dhe sot kërkoi që shuma të jetë 4000.00E. ka qenë ferma më e pastërtë, më e mira na vjen shumë keq për se si ka përfunduar kjo punë por ne do ta përkrahim me 4000.00E e kam si kërkesë nga Drejtoria e Bujqësisë me mbështet Zijadin Paqarizin.

**Argjend Thaçi:** E hapi debatin për këtë pikë. Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Sigurisht që Drejtori i cekit të gjitha ato që është dashur të cekën, ne pajtohemë si grup parlamentar dhe besoj që pa dallim në kuvend duhet ta mbështesim. Nuk e di nëse është dëmtuar më shumë ndokush se ai, sepse në kohën kur është dashur të shitet mishi i është ndaluar shitja e tyre dhe qumështi pastaj vrasja e bagëtive. Për ne nëse kishte mundur Komuna dhe shumën më të lartë me ja dhënë ne e kishim mbështet.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Arlind Morina!

**Arlind Morina:** Përvendetje për të gjithë!

Falenderoj Drejtorin për dy pikat e më herëshme të cilat i prezantoj por dhe për këtë kërkesën tani. Ne si grup parlamentar e mbështesim.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Sa i përket kësaj mbështetje të personi që merret me bujqësi duke e ditur faktin që para disa viteve ka pasur keqëpërdorime dhe njerëz të ndryshëm kanë përfituar subvencione të ndryshme, unë pak a shumë këtë familje e njoh dhe është një familje e cila mirret me bujqësi dhe në cilësin e përsaqësuesit e përsaqësusesit të Kuvendit Komunal e mbështes këtë kërkesë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesë Kastrati!

**Agnesë Kastrati:** Edhe ne si grup i VV-së e mbështesim këtë kërkesë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush Helshani!

**Amrush Helshani:** Grupi parlamentar i NISM-ës mbështet kërkesën e Drejtorit të Bujqësisë për ti ndihmuar fermerit në fjalë.

**Argjend Thaçi:** 26 anëtar jemi prezent. Kush është për miratimin e kësaj kërkesë që ti ndahan 4000.00E fermerit Zijadin Paqarizit?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/210 datë: 20.04.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku. Kemi të bëjmë me një kërkesë të këmbim të pronës, ndoshta e keni parë kërkesën. Pas shkresës të cilën e kemi bërë Drejtoris për Kadastër kemi të bëjmë me një investim apo që është i paraparë në plan zhvëllimor. Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Kjo parcelë e cila po kërkohet të përvetësohet në këmbim të një parcelës tjetër, a është e lirume kjo hapsir e komunës, a ka ndërtim në këtë hapsir. Unë nuk jam në këtë formë me ja dhënë hapsirën në mes të Malishevës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj:

**Valon Zogaj:** Unë e kam ngritur në KPF dhe kam qenë me ndal në KPF. Nëse sot jemi duke e diskutuar këtë kërkes nesër kemi me i pasur dhe shumë të tjera, sepse secilit i takon me dhënë një pronë që është në territor të Malishevës por është shumë larg në zonë dhe me marrë një zonë rrëth lumit apo rrëth parkut. Unë jam në parim që secila kërkes që vjen me u trajtu në mënyr specifike prej të dy Drejtoreve Urbanizmit dhe Gjeodezisë dhe me na sjellë cili është interes i Komunës. Ne jemi kundër kësaj.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Sa i përket kësaj qështje unë mendoj që është më mirë me shty për seancën e ardhshme, për me marrë informacione dhe me ditë realisht vleren e parcelave. Po pajtohem me kolegë që nesër mundet me ardhë një kërkes tjetër me bërë një ndërrim të parcelave ku vlera e parcelave nuk është e barabartë.

**Argjend Thaçi:** E kemi pasur në seancën e kaluar e kemi shtyrë për këtë seancë.

**Gentianë Hoti:** Unë dhe në mbledhjen e kaluar në KPF kam kërkuar që kërkesat e kësaj natyrës të na dërgohen në email që të shohim se qfarë jemi duke votuar. Unë mendoj që është më mirë me u shty kjo pikë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kësaj kërkese?

Për: 8

Kundër: 16

Abstenim: 4

Me 8- Për, 16- Kundër, 4- Abstenime, nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/390 datë:05.09.2022, e parashtruar nga Sabit Mazreku.

Urdhëro, Valon Mazreku!

**Valon Mazreku:** Kërkesa për nga specifika është e ndryshme këti i është marrë toka, i është marrë për gjat tërë parcelës së ti toka e cila është ndërtuar trotuari i rrugës Hamdi Berisha. Dhe ky ka kërkua me marrë atë parcel që gjindet mbi parcelën ku i është marrë për trotuar ka kërkuar me ju kompenzu ajo pjesë që i është marrë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kësaj kërkese?

Për: 8

Kundër: 18

Abstenim: 3

Me 8- Për, 18- Kundër, 3- Abstenime nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesën nr.02/565 datë:22.11.2022, e parashtruar nga Murtez Thaçi, Sahit Thaçi dhe Flurim Thaçi.  
Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Kërkes e natyrës së njëjt me kërkesën të cilën sa po e votuam dhe këtyre ju është marrë një parcelë te liqeni,nëse ka kérku me ju bërë këmbimi brenda asaj zone është në rregull.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/565 datë:22.11.2022, e parashtruar nga Murtez Thaçi, Sahit Thaçi dhe Flurim Thaçi.

Për: 13

Kundër: 5

Abstenim: 10

Me 13- Për, 5- Kundër, 10- Abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/385 datë:14.03.2023, e parashtruar nga Adem Hoti. Kemi të bëjmë dhe këtu me një kërkes për parcelë për ndërtim të shtëpis që është në fshatin Carralluk. Rasti ka të bëjë për një shtëpi që të i ndërtohet për ndihmë, por parcela që është nuk është në emër të tij dhe nuk i është ofruar mundësia për ndërtimin e shtëpis.

Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Në këtë kërkes duhet me pasë dhe numrin e parcelës me ja nda parcelën, numri i parcelës nuk është.

**Valon Mazreku:** Unë po e shoh një diskripance në mes të Nismës dhe LDK-së, nuk ka bashkëpunim njëra është për këtë tetra është për atë tjetren. Me qfarë logjike ne po e dhëjmë pronën publike të Malishevës në mes të Malishevës dhe po shkojmë po e rrëzojm me lëshu pronën publike që ka pasur fitim miljona euro. Nëse dikujt i kemi thënë liroje pronën publike është i barabartë me të gjithë ne, nuk mundemi me funksionu me dy standarte, mua po më thua liroje pronën publike me 10m<sup>2</sup> ndërsa këti dëshiron me ja liru pronën publike me 100m<sup>2</sup>. Ne jemi duke bërë shkelje në Kuvend, mos prisni me pas përkrahjen time në këtë rast.

**Argjend Thaçi:** Unë mendoj që prona e ozupuar duhet të lirohet dhe përderisa kemi kërkesa legjitime duhet të i trajtojna. Urdhëro, Valon Krasniqi.

**Valon Krasniqi:** Sa i përket kësaj kërkese pajtohem me bërë një zgjidhje për me i ndihmu kësaj familje që ka nevojë për ndërtimin e një shtëpie, por nuk pajtohem me qasjen e kërkesës se si na është ardhë në kuvend. Këtë kërkes nuk e ka bërë Kryesia legjitime e fshatit Carrallukë, kjo kërkes nuk ka asnjë lloj legjitimiteti.

Sallën e liruan: Kryesusi i Kuvendit Argjend Thaçi, Arlind Morina, Hamit Limaj, Driton Kastrati, Zamire Morina. Vazhdimin e seancës e bëri asambleisti më i vjetër në Kuvendin e Malishevës, Eqrem Morina.

**Eqrem Morina:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Kush e ka lexuar ligjin për këmbim të pronës qoftë publike apo private dhe nëse marrim vendim ne për miratimin e kësaj kërkesë këtë do ta kthejë MAPL-ja sepse nuk lejon me ndërtuar shtëpi në pronë publike.

**Eqrem Morina:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Unë e kam ngritur shqetësimin tim kërkesat të qytetarëve e kësaj natyre të cilat po vinë janë të pa kompletuara, që shumicën e rasteve dalin dhe qesharake. Kërkesat e pronave në këtë rast nuk mundemi me shqyrtu sepse nuk ka asnjë numër të parceles dhë qka po votojmë ne. Ka shumë kërkesa të natyrës së njejtë dhe fare nuk e marrin mundin as në Kuvend me i sjellë, sepse nuk i shkon përshtati x personit. Ne jemi duke e degradu Kuvendin me kësi kërkesa. I kemi thënë dhe Kryetarit dhe Drejtorit se kur vin kërkesa të natyrës së njëjtë të mos na qesin në pozit të vështirë por të tregojn vetë sa është mundësia me i ndihmu dhe ta miratojmë.

**Eqrem Morina:** Urdhëro, Gentianë Hoti!

**Gentianë Hoti:** Personi në fjalë është i fshatit Carrallukë aty ku po kërkon pronë është duke jetuar, jeton në kushte shumë të vështira e gjithë lagjia së bashku me shoqatën Jetimat e Ballkanit po dëshirojnë me ja ndërtu një shtëpi. Pa qenë një leje e Komunës as shoqata e Jetimave të Ballkanit nuk investon aty. Ne ose duhet ta gjejmë një zgjidhje ose të ja dhëjmë pronën në shfrytëzim duhet me i dhënë epilog kësaj qështje nuk mundemi ne vetëm me refuzu. Ne kur e kemi kalu me ardhë në kuvend e kemi votuar me miratimin e Drejtoris së gjeodezis që ata me i caktu pikat se qysh apo ku ne mundemi me ja dhënë parcelën në shfrytëzim.

**Labinot Gashi:** Unë jam me i ndihmu, por nuk kemi specifikacion është dashur të vijë prej Drejtoris me dokumentacion të kompletuar.

**Eqrem Morina:** Urdhëro, Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Sa i përket këtyre kërkesave dhe unë pajtohem me Valonin se ne nuk mundemi me punu me dy parë kritere.

**Bashkim Krasniqi:** Unë mendova që keni me kërkuar sqarime te pikat paraprake. Të tri pikat për këmbim të pronës e kanë të njëjtën tem janë të bazuara në ligj, lejohet këmbimi i pronës vetëm se duhet të arsyetohet se cili është qëllimi. Te dy pikat ku njëren jemi duke e trajtuar ka të bëjë me një lloj ndihme që Komuna po tenton me ju bërë këtyre dy personave, ne e kemi bërë dhe qërtifikatën e pronës dhe skicën e pronës në Kuvend nuk e di përsë nuk ju është ardhur. Ne e kemi sjell lokacionin ku pretendohet të bëhet, është një vend ku mundet me ju dhënë palëve. Qështja tjetër se a ka të drejt Kuvendi me nda troje apo jo nuk mundem me komentu këtë rast.

**Eqrem Morina:** Urdhëro, Gentianë Morina!

**Gentianë Morina:** Unë kërkoj që kjo kërkesë të shtyhet për seancën e radhës, të kompletohet dokumentacioni dhe pastaj të vjen në Kuvend.

**Eqrem Morina:** Kush është për shtyrje të kësaj kërkesë?

Unanimisht, shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/637 datë:22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi.  
Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Të dy rastet dhe rastin paraprak janë të njëjt por ky është më i ndjeshëm për arsyen e gjendjes së këti personi, ne mundemi me marrë vendim për të dy rastet por MAPL-ja na kthen si kundërligjshme. Unë jam për me shty këtë kërkesa dhe me gjetë një modalitet.

**Egrem Morina:** Kush është për shtyrje e kërkesës nr.02/637 datë:22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi.

Unanimisht, shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me 5 minuta pauz dhe rikthehemë prapë.

Pasi që Kryesusi i Kuvendit nuk është këtu rekmandoja që këto kërkesa të shtyhen për mbledhjen e ardhshme.

Kush është për ndërprerje të seancës?

24 anëtar jemi prezent dhe me vota unanime ndërprenim seanca.

Ju falenderoj për pjesmarrje!

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 16:30.

Procesmbajtësja:

Argentië Krasniqi

